

Vrojtime leksikografike

Fjalët e urta në FGJSSH

Mr. Agim Spahiu

10 nëntor 2008

Përmbledhje

Në këtë shkrim flitet për përfshirjen e **proverbave** në Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe të vitit 1980, për vetë faktin se kjo vepër e njohur leksikografike ka vënë në spikamë një numër shumë të madh të tyre. Sortimi dhe radhitja është bërë gjithnjë duke u mbështetur në programet e njohura të Linux-it dhe duke u mbështetur në shkurtesën **fj.u.** që do të thotë **fjalë të urta**.

Në këtë **Fjalor** fjala **PROVERB** është përkufizuar në këtë mënyrë:

Fjali e shkurtër, që shpreh një mendim të plotë, të figurshëm e të mprehtë, i cili përgjithëson përvojën e shumë brezave dhe zakonisht përmban një mësim të urtësisë popullore për jetën e për dukuritë e ndryshme të saj; fjalë e urtë (p. sh. «**Që në gusht, e nga një grusht**»; «**Puna është faqebardhë**»; «**Buka e botës, laku i kokës**»; «**Një krimb than një lis**»; «**Njeriut iu bëj njeri, ariut iu bëj ari**» etj.

Edhe ky Fjalorth i fjalëve të urta a proverbave u realizua me ndihmën e programeve të Linux-it, të cilin do ta shtjellojmë këtu më poshtë.

- | | |
|---|--|
| AFËR Është me afër dera se qilari fj. u. shih te DER/Ë, ~A. | ARMIK m. Bëj armiq. Darova e armikut o helm, o thikë. fj. u. armiku kurrë nuk ta do të mirën, mos prit të mirë nga armiku. Armikut dhe erës tregoju gjoksin! fj. u. mos u përkul përpara armikut; mos u tremb nga vështirësitë. |
| AGURIDH mb. 3. si em. ~E, ~JA f. zakon. ~E, ~ET. Dalëngadalë aguridhja bëhet mjaltë. fj. u. | ARNOJ kal. * Gris (prish) gjirin, arno pëqirin! fj. u. shih te GRIS. |
| AI përem. Ai që s'ka kokë, ka këmbë. fj. u. | ARRAKAT mb. Delen arrakate e ha ujku. fj. u. |
| ARË f. Kur s'ke ara në mal, pse bën dava me çakejtë? fj. u. mos u ngatërro në një punë që nuk të përket. | ASNJË pakuf. Një si asnjë fj. u. shih te NJË. |
| ARI m. S'ngopet ariu me miza fj. u. Nuk trembet ariu (arusha) me shoshë fj. u. shih te SHOSH/Ë, ~A. | |

- ATDHE** m. Duaj atdheun, si shqipja folenël fj. u.
- ATJE** ndajf. Qeni leh atje ku ha fj. u. keq. shih te QEN,~I.
- AVASH-AVASH** ndajf. bised.
Dalëngadalë. Erdhi avash-avash. Avash-avash bëhet shelegu dash. fj. u.
- BABËZI** f. Fjalët e shumta janë babëzi. fj. u.
- BABO** f. vjet. Shumë babo e mbytin fëmijën fj. u. kur ndërhyjnë shumë veta në një punë, e prishin në vend që ta ndreqin.
- BAGËTI** f. Njeriu pa dituri është pors bagëti. fj. u.
- BAHÇE** f. bised. Bahçja me lule dhe bota me njerëz kanë hije. fj. u.
- BAJRAK** m. 1. vjet. Flamur. Shpirtin jepe e shko, bajrakun mos e dorëzo! fj. u.
- BAKLAVA** f. Nuk bëhet bakllava me miell thekre fj. u. nuk bëhet mirë një punë kur mungojnë mjetet e nevojshme. Nuk lyhet (nuk fëlliqet) dielli me baltë fj. u. shih te DIELL,~I. I zoti e nxjerr (e qit) gomarin nga balta fj. u. punën e kryen ai që e ka përsipër, i zoti i punës e nxjerr atë në krye. Këmbë për baltë, gojë për mjaltë fj. u. ai që punon, ka edhe të hajë.
- BALLAMAR** m. 2. Litar i trashë që përdoret për të lidhur mallrat e ngarkuara në një mjet. Lidh me ballamar. Dy të marrë këputin një ballamar. fj. u.
- BARDHAK** m. Ç'ka barku e nxjerr bardhaku fj. u. atë që e fsheh ose e bluan njeriu në mendje, e nxjerr kur është i pirë.
- BARDHË** mb. Delja e zezë s'bëhet kurrë e bardhë fj. u. shih te DEL/E,~JA.
- BARI** I m. Dhentë pa bari i ha ujku një nga një fj. u. pa një udhëheqje të mirë, bëhesh pre e armikut. Gjej njëherë bari, pastaj shko e bli dhi! fj. u. merr të gjitha masat e nevojshme, para se të nisësh një punë.
- BARK** m. Shqiptarin nuk e ka nxjerrë lokja prej barkut, por huta prej çarkut. fj. u. Ç'ka barku e nxjerr bardhaku fj. u. shih te BARDHAK,~U.
- BARKBOSH** mb. Barkploti s'ia qan hallin barkboshit. fj. u.
- BARKDREQ** m. shar. Puno fatkeq, ha barkdreq fj. u.
- BARKNGOPUR** mb. 3. Përd. em. sipas kuptimeve të mbiemrit. Sa t'i bjerë ndërmend barkngopurit, i ka dalë shpirti barkzgropurit. fj. u.
- BARKPLOT** mb. 2. si em. ~, ~I m. ~Ë, ~ËT. Njeri që është i ngopur; i pasuri, pasaniku; kund. barkzbrazuri. Barkploti nuk i zë besë barkboshit. fj. u.
- BARTEM** vetv. pës. S'bartet çorba me kaçile fj. u. shih te ÇORB/Ë,~A.
- BARRË** f. Barra e lehtë ngrihet me kollaj. fj. u. Nata është me barrë fj. u. shih te NAT/Ë, ~A.
- BASHKË** ndajf. Nuk fle (nuk kullot) delja me ujku bashkë fj. u. shih te DEL/E,~JA.
- BASHKIM** m. Bashkimi bën fuqinë. fj. u.
- BASHKOHEM** vetv. U ndave - u përlave, u bashkove - u forcove. fj. u.
- BAXHANAK** m. Dy baxhanakë mbajnë shtegun e ariut. fj. u.
- BEHAR** m. Ç'lë dimri, e gjen behari. fj. u.
Dimri ha beharin fj. u. shih te DIM/ËR,~RI. Me një lule (me një dallëndyshe) s'vjen behari (pranvera) fj. u. shih te LUL/E,~JA.
Beli ka (edhe) bisht fj. u. çdo veprim ka edhe pasojat, dardha e ka bishtin prapa.
- BERBER** m. Te koka e qerosit të gjithë bëhen berberë fj. u. shih te QEROS, ~I.
- BEREQET** m. bised. Bereqetin e njeh drapri. fj. u.
- BERR** m. Çdo berr varet nga këmbët e veta fj. u.

- BESË** f. Besa e shqiptarit si purteka e arit. fj. u. Besa e burrit-pesha e gurit. fj. u. Besa e shqiptarit është shqiptaria. fj. u. Mos i zër besë gjarprit! fj. u. shih te GJARP/ËR,~RI 2.
- BESËSHKALË** mb. Më mirë i vdekur se besëshkalë. fj. u.
- BËHEM** vetv. Themeli çati s'bëhet. fj. u. Gur, gur bëhet mur. fj. u. S'bëhet vreshti me urata, po me shata e me lopata. fj. u. Sipas vendit bëhet kuvendi. fj. u. S'bëhet deng me rrush (s'bëhet rrushi deng) fj. u. shih te RRUSH,~I. Shpatullat s'bëhen tri fj. u. shih te SHPATULL,~A.
- BËJ** kal. Bëj atë që duhet, mos vështro se ç'thuhet. fj. u. S'bëjnë dardhat në shënëndre. fj. u.
- BËRË** f. Të bërat nuk zhbëhen dot. fj. u. S'i ndan të thënat nga të bërat.
- BËRTAS** jokal. I bërtet së bijës, të dëgjojë e reja. fj. u.
- BËRRAKË** f. Gjeli në darkë, shiu në bërrakë. fj. u.
- BËRRYL** m. Shoku njihet në bërryla fj. u. shoku a miku i vërtetë njihet në çaste të vështira, kur dikush ndodhet ngushtë!
- BIÇAK** m. Thikë e vogël, me presë që hapet e mbyllet në një dorezë druri, kocke etj.; thikë xhepi, brisk xhepi. Biçak, buke. Pres (grij, kruaj) me biçak. Ha pak e bli biçak. fj. u.
- BIE** I jokal. Dardha nën dardhë bie. fj. u. Shpëtoi nga shiu e ra në breshër. fj. u. Shpëtoi nga lumi e ra në det. fj. u. Iku nga tymi e ra në zjarr. fj. u. S'bie rrufeja dy herë në një lis. fj. u. Nuk i hipën dot dardhës, i bie fikut. fj. u. S'ka ç'i bën gomarit, i bie samarit. fj. u. Kur ta varësh zilen, duhet t'i biesh. fj. u. Po s'hëngre hudhra, s'bie erë. fj. u. S'i bihet murit me kokë. fj. u. Vaji në lakra bie fj. u. nuk vete dëm diçka, aty e ke. Gjalpi në lakror bie (derdhet, mbetet) fj. u. vaji në lakra bie.
- BIE** II kal. Ç'bie sahati, nuk bie moti. fj. u.
- BIJË** f. Kur vjen bija, qesh shtëpia. fj. u. I bërtet së bijës, të dëgjojë e reja. fj. u.
- BIMË** f. Duket bima që kur mbin fj. u. një punë e mbarë duket që në fillim, dita e mirë duket që në mëngjes.
- BINA** f. bised. Binaja s'mbahet pa shtylla. fj. u.
- BIRREM** vetv. Për gozhdën birret potkoi. fj. u.
- BISHT** m. Sqepari s'e gdhend bishtin e vet. fj. u. Gjeti bishtin sëpata, pyllin e mori data. fj. u. Beli ka (edhe) bisht fj. u. shih te BEL,~I II. S'ka mbetur laraskë pa bisht fj. u. shih te LARASK/Ë,~A. Dardha e ka bishtin prapa fj. u. shih te DARDH/Ë,~A. Mos e prek në bisht, se të ha në gisht! fj. u. thuhet kur dikush i futet pa qenë nevoja një pune që mund t'i sjellë rreziqe të mëdha; mos luaj me zjarrin!
- BJERRAMOT** m. Ai që e humb kohën kot. Punëkoti, bjerramoti. fj. u.
- BLEJ** kal. Shet e blen. Këpucën blije sipas këmbës. fj. u. Gjej njëherë bari, pastaj shko e bli dhi! fj. u. shih te BARI,~U.
- BLUAJ** kal. Kush mëngon, bluan. fj. u. Dhëmbi bluan malin. fj. u. Bluaje, pa thuaje! fj. u. Mulliri bluan me aq ujë sa ka fj. u. shih te MULLI,~RI.
- BOLLË** f. zool. Zure bollën, shtypi kokën! fj. u. për armikun mos ki mëshirë. Nuk i tregon bolla (gjarpri) këmbët fj. u. shih te GJARP/ËR,~RI.
- BORË** f. kryes. nj. Mali më i madh ka borë më shumë. fj. u.
- BORXH** m. Fli pa darkë e zgjohu pa borxh. fj. u.
- BOSTAN** m. Dy bostane nuk mbahen në një dorë. fj. u.
- BOSH** ndajf. bised. Më mirë djepin bosh (thatë) se shejtanin brenda fj. u. shih te DJEP,~I.

- BOTË** I f. Mos hyr në pus me litarin e botës. fj. u. Mos shtjer kripë në gjellën e botës! fj. u. Bota është e rrumbullakët fj. u. shih te **RRUMBULLAKËT** (i,e). Kali i botës të lë në udhë fj. u. gjëja e huaj s'të mbaron punë. S'merret bota në krahë (në kurriz) fj. u. nuk është e mundur të bëhen a të mbarohen të gjitha punët menjëherë, punët duhen bërë me radhë sipas kushteve e mundësive. Pula e botës duket më e majme fj. u. iron. shih te **PUL/Ë,~A**.
- BREDHARAK** mb. Bredharaku nëpër rrugë rri. fj. u.
- BREG** m. Ku është fushë, bëhet breg fj. u. shih te **FUSH/Ë,~A**.
- BREGORE** f. Maja e bregores. Bregoret në fushë rrëfejnë si male. fj. u.
- BREJ** kal. Uria bren gurët. fj. u.
- BRENDA** Kush i bën varrin shokut bie vetë brenda. fj. u.
- BRENGË** I f. Brenga e shkuar, brenga e harruar. fj. u.
- BRESHËR** m. S'qëndron breshri mbi breshkë fj. u. në rrethana të tilla s'bëhet punë, nuk ecën puna kështu, është e pamundur të bëhet (një punë). Kush mbjell duhi, korr breshër e shi fj. u. shih te **DUHI,~A**.
- BRESHKË** f. S'ka fushë pa breshkë fj. u. s'ka gjë fare pa të meta. S'qëndron breshri mbi breshkë fj. u. shih te **BRESH/ËR~RI**.
- BRI** m. Humbi qetë e pyet për brirët fj. u. shih te **HUMB**. Shkoi shyta të kërkojë brirët, la edhe veshët fj. u. iron. shih te **SHYT/Ë~A**.
- BRINJË** f. Lepuri në brinjë e heli në zjarr. fj. u.
- BRUMBULL** m. zool. * Kush shkon pas brumbullit, te plehu do ta shpjerë fj. u. kush shkon pas një njeriu të keq, përfundon keq.
- BRUMË** m. Vjen brumi. Si të jetë brumi, del edhe buka. fj. u. Kush zë brumë, do të gatuajë. fj. u. Pa brumë nuk bëhen kuleçtë. fj. u.
- BRYMË** f. Bryma s'është dëborë fj. u. të gjithë ata që i ngjajnë njëri-tjetrit nuk janë njësoj (thuhet zakonisht për të daluar një njeri më pak të aftë nga një tjetër që është shumë i zoti, kur të dy kanë ndonjë tipar të përbashkët joqenësor).
- BUF** m. Leshtë e ujkut, thonjtë e bufit fj. u. shih tek **UJK,~U**.
- BUJAR** mb. Ndhimë bujare. Sa bujar je, aq miq ke. fj. u.
3. Përd. em. sipas kuptimit 1 të mbiemrit. Bujar i madh. Shtëpia e bujarit është e mikut dhe e shtegtarit. fj. u.
- BUJK** m. E bën bujku arën, s'e bën ara bujkun. fj. u. Po të kishte frikë bujku nga krimbat në arë, nuk do të mbillte kurrë farë. fj. u.
- BUKË** f. Bukë e hi dhe shtëpi. fj. u. Buka pa përtypur nuk kapërcehet. fj. u. nuk mund të zgjidhen çështjet pa punë e përpjekje. Nuk piqet buka me shkarpa fj. u. shih te **SHKARP/Ë,~A**. Ka thelb buka fj. u. shih te **THELB,~I**. Kush ha bukë, bën edhe thërrime fj. u. po punove do të bësh edhe ndonjë gabim të vogël, puna ka edhe ndonjë te metë të vogël. Buka që thyhet, s'ngjitet më fj. u. po u prish miqësia e vërtetë, s'ndreqet më, nuk bëhet më e tillë siç ishte. Shpjer gojën te buka e jo bukën te goja fj. u. përpiqu, luaj këmbë e duar, puno që të sigurosh atë që të duhet.
- BURIM** m. Burimin e mirë e ke edhe në thatësirë. fj. u. Ç'ujë ka lumi në burim atë ka edhe në grykë. fj. u.
- BURON** jokal. 1. Del vetë nga thellësia në sipërfaqe të tokës (për ujin, për naftën etj.). Buron ujë (naftë, gaz). Ku buron, rrjedh. fj. u.
- BURRË** m. Burri s'matet me pëllëmbë, po me zemër. fj. u. Nuk lind burri me mustaqe. fj. u. Druri nga pemët, burri nga

- punët. fj. u. Kalin e njeh barra, burrin e njeh puna. fj. u. Burrë e grua, mish e thua. fj. u. Muri luan, burri s'luan. fj. u. Kau lidhet për brirësh, burri për fjalësh. fj. u. Fjala e burrit - pesha e gurit. fj. u. Edhe burrat kanë burra fj. u. ka trima, por ka edhe më trima; trimëria, burrëria e zotësia s'kanë kufi. Burrin e prishin (e çartin) huqet fj. u. veset e këqija prishin edhe atë më trimin e më të zotin. S'lind burri me mustaqe fj. u. shih te MUSTAQ/E,~JA.
- BUSH** II m. mit. Qenie e përfytyruar si kafshë, e cila, sipas besimeve të kota, jetonte nëpër kënetat dhe ndillte shi duke ulëritur. Si deshi bushi, bëri koha. fj. u.
- BUSHTËR** f. Bushtra që nxiton shumë, pjell këlyshë të verbër. fj. u.
- BUTË** mb. Lima e butë të ha trutë. fj. u.
- CAK** m. Dera e përtimit, caku i mjerimit. fj. u.
- CARAN** m. Carani e ka vendin në vatër. fj. u.
- CEP** I m. Po më shtrove cepin e gunës, të shtroj gunën të tërë. fj. u.
- CIPAL** m. S'mbahet shtëpia me cipal. fj. u.
- CIPË** f. Plasi cipa, doli kripa. fj. u.
- CIRIPUPE** f. Mos ta mundtë qyqja, se ta mund edhe ciripupja. fj. u.
- CIRKË** f. Cirka shpon gurin. fj. u.
- CIRKOHEM** vetv. Po hëngre me foshnjat, do të cirkohesh. fj. u.
- CJAP** m. zool. Cjapi edhe pa mjekër cjamin mbetet. fj. u.
- COFËT** mb. Gomari i cofët nuk i tutet ujkut. fj. u.
- COPË** f. Kush kërkon copën e madhe, humbet edhe të voglën. fj. u. Ku të tregojnë copën e madhe marr lugën e vogël fj. u. shih te LUG/Ë,~A.
- ÇAHEM** vetv. Lisi çahet me pyka. fj. u.
- ÇAJ** kal. E vërteta çan (edhe) gurët. fj. u. Me gojë të lan, me dhëmbë të çan. fj. u.
- ÇAKALL** m. sh Çakalli bëri kërdinë, ujkut i doli nami. fj. u. Kur s'ke ara në mal, pse bën dava me çakejtë? fj. u. shih tek AR/Ë,~A.
- ÇALË** mb. 4. Përd. em. sipas kuptimit 1 të mbiemrit. Gjeti i çali të tatëpjetën. fj. u. u krijua rrethana ashtu siç i vjen mbarë dikujt. Po të qëndrosh me të çalin, do të mësosh të çalosh fj. u. po të rrih me njerëz të këqij, do të marrësh veset e tyre.
- ÇALUJ** jokal. S'çalon gomari nga veshët fj. u. nuk e pengon punën një e metë e vogël dhe fare pa rëndësi.
- ÇAP** I m. Bëje (mate, lëshoje) vrapin sa ke çapin (hapin) fj. u. shih te VRAP,~I 3.
- ÇAPË** II f. krahin. 1. Kafshatë. Çapa e madhe të zë fytin. fj. u.
- ÇARÇAF** m. Sa një çarçaf. Shkorsa çarçaf nuk bëhet. fj. u.
- ÇARK** m. Shqiptarin nuk e ka nxjerrë (nuk e ka qitur) lokja prej barkut, por huta prej çarkut fj. u. shih te HUT/Ë,~A II.
- ÇAST** m. Atë që sjell çasti, s'e sjell moti. fj. u.
- ÇATI** f. Në çati ngjiten me shkallë fj. u. shih te SHKALL/Ë,~A. I zoti e di ku i pikon çatia (shtëpia) fj. u. shih te ZOTI (i).
- ÇDO** pakuf. Nuk bën mjaltë çdo mizë. fj. u.
- ÇEL** kal. Sa lule çelin, të gjitha s'lidhin. fj. u.
- ÇENGEL** m. Çdo mish (berr) varet nga çengel e vet (nga këmbët e veta) fj. u. shih te MISH,~I.
- ÇETUR** m. Prilli mbulon gurët, maji mbush çeturët. fj. u.
- ÇIKOJ** kal. Në mos rrjedhtë, çikon. fj. u.
- ÇIL** mb. Prit çil të hash tërfil. fj. u.
- ÇIRAK** II m. Çiraku s'i sheh këmbët e veta. fj. u.
- ÇMENDUR** m. Të dehurit i liron rrugë edhe i çmenduri. fj. u.
- ÇOJ** I kal. Çon një pelë e ha një thelë fj. u. shih te PEL/Ë,~A.

- ÇOJ** II kal. Një gur s'çon (s'bën) mur fj. u. shih te GUR,~I.
- ÇOKALE** f. Pelën shite, po çokalen ruaje. fj. u.
- ÇOKANE** f. Nuk më lënë zilet e mia të dëgjoj çokanet e tua. fj. u. kam aq shumë telashe për vete, sa nuk kam mundësi të ndihmoj një tjetër.
- ÇORBË** f. S'bartet çorba me kaçile fj. u. është punë që s'bëhet, s'mbahet uji me shoshë.
- ÇULL** m. Kali i mirë duket nën çull. fj. u.
- DADË** f. Shumë dada e mbytin fëmijën. fj. u.
- DAI** m. 1. Burrë trim e bujar. Mos u bëj dai me xhep të huaj. fj. u.
- DAL** jokal. Doli fjala nga dhëmballa, e merr vesh e gjithë mëhalla. fj. u. Shkëndijat (shkëndijëzat) dalin në maj fj. u. shih te SHKËNDIJ/Ë,~A. S'del vaj nga guri fj. u. shih te VAJ,~4. S'del dhjamë nga pleshti fj. u. përçm. shih te DH-JAM/Ë, ~I. Shkoi (vajti) për lesh e doli (u kthye, erdhi) i qethur fj. u. iron. shih te LESH,~I. Më mirë të të dalë syri sesa nami fj. u. shih te SY,~RI. Hesapi i shtëpisë nuk del në pazar fj. u. shih te HESAP,~I. S'dalin dy lëkurë nga një dele (nga një berr) fj. u. shih te
- DALLËNDYSHE** f. Me një dallëndyshe (me një lule) s'vjen pranvera (behari) fj. u. shih te LUL/E,~JA.
- DARDHË** f. Dardha e ka bishtin prapa fj.u. çdo punë, që mund të duket e lehtë e pa telashe, ka edhe pasoja të paparashikuara (zakonisht kur pasojat janë jo të mira).
Kush rri nën dardhë, i ha kokrrat fj. u. Nuk i hipën dot dardhës e i bie fikut fj. u. s'ka ç'i bën gomarit e i bie samarit. Pemën, kur s'pjell, e presin se i bën hije dardhës fj. u. shih te PEM/Ë,~A.
- DAROVË** f. vjet. Dhuratë që i jepej dikujt (zakonisht nuses); peshqesh. Jepnin darova. Solli darova. Darovë e armikut - o helm, o thikë. fj. u.
- DASMË** f. S'bëhet dasma me një fyell fj. u. shih te FYELL, ~I. Dasmë pa mish nuk ka (nuk bëhet) fj. u. nuk ka luftë e fitore pa gjak, në çdo luftë ka edhe të vrrarë. S'ka dasmë çdo ditë (për ditë) fj. u. s'ka përherë të mira e gëzime. S'prishet dasma për një qepë (për një limon)fj. u. nuk duhet prishur a nuk duhet lënë një punë e madhe për diçka të vogël e fare të parëndësishme. Nuk shkohet me tre rupe në dasmë fj. u. shih te RUP,~I. Atje ku bëhet dasmë e madhe, merr lugë të vogël! fj. u. shih te LUG/Ë,~A.
- DASH** m. Avash, avash bëhet shelegu dash. fj. u. Dashit të rritur nuk i dridhet briri. fj. u.
- DAULLE** f. Daullja bie për ata që kanë veshë fj. u. e mira vjen për ata që e kuptojnë e dinë të përfitojnë; kush ka mend, e kupton.
- DAVA** f. bised. Kur s'ke ara në mal, pse bën dava me çakejtë? fj. u. shih tek AR/Ë,~A.
- DEGË** f. Nuk ka degë pa rrënjë fj. u. shih te RRËNJ/Ë, ~A I. Mos mburr degët pa parë rrënjët fj. u. shih te RRËNJ/Ë,~A I.
- DEHUR** mb. 2. Përd. em, sipas kuptimit të mbiemrit. Britma të dehurish. I marri i hap udhë të dehurit. fj. u.
- DELE** f. Nuk fle (nuk kullot) delja me ujkun bashkë fj. u. nuk mund të ketë paqe e bashkëpunim ndërmjet atij që është i ndershëm e punëtor dhe armiqve të egër e të pabesë. Delen e vetme (që ndahet nga tufa) e ha ujku fj. u. ai që ndahet nga shokët, nga kolektivi e pëson keq. Delja ka kullot, atje lë leshin fj. u. thuhet për një njeri, i cili i shërben atij që i jep të hajë, që e paguan. S'dalin dy lëkurë nga një dele (nga një berr) fj. u. shih te LËKUR/Ë,~A 1. Delja e zezë s'bëhet kurrë e bardhë fj. u. njeriu i lig ose armiku nuk mund të bëhet kurrë i mirë; ujku qimen e ndërron, por lëkurën nuk e ndërron. Dhia në malësi, delja në vërri fj. u. shih te DHI,~A.

- DEM** m. Demin e shtron zgjedha fj. u. shih te ZGJEDH/Ë,~A.
- DENG** m. Bëhet deng me rrush (s'bëhet rrushi deng) fj. u. shih te RRUSH,~I.
- DERDHËM** vetv. Gjalpi në lakror derdhet (bie, mbetet) fj. u. shih te BIE I. U derdh vaji, s'mblidhet më fj. u. shih te VAJ,~I I.
- DERË** f. Nuk ka shtëpi pa derë. fj. u. në çdo rast mund të gjendet një rrugëdalje, s'ka punë që nuk zgjidhet. Është më afër dera se qilari fj. u. thuhet me ironi kur dikush sheh me parë interesin vetjak a të rrethit të tij të ngushtë, pastaj atë të përgjithshmin. E drejta i ka pemët te dera fj. u. shih te DREJT/Ë,~A (e) 6.
- DERËHAPUR** mb. 3. Përd. em. sipas kuptimit 1 të mbiemrit. Derëhapuri derëmbylur s'bëhet. fj. u.
- DERR** m. Derri do plumb fj. u. armiku duhet asgjësuar me mënyra e me mjete të forta, nuk ka mëshirë për armikun; e keqja duhet zhdukur menjëherë e me rrënjë. Nuk ka pyll pa derra fj. u. bashkë me të mirat do të gjesh edhe ndonjë gjë të keqe; s'janë të gjithë të mirë, midis shumë të mirëve ka edhe ndonjë të keq. Të gjithë derrat një turi kanë fj. u. njerëzit e këqij të gjithë njëloj janë, pavarësisht nga ndonjë dallim i vogël midis tyre. Nuk fshihet derri në thes fj. u. nuk mund të fshihet a të mbulohet e vërteta.
- DET** m. Deti s'kalohet me këmbë fj. u. është e pamundur të bëhet.
Ç'bën në det, e gjen në kripë fj. u. e keqja që kërkon t'i bësh tjetrit, do të vijë një ditë e do të të bjerë mbi kokë. S'matet deti me pëllëmbë fj. u. shih te PËLLËMB/Ë,~A. Nuk soset (nuk thahet) deti me lugë fj. u. thuhet kur diçka është e pamundur të bëhet, sepse mungojnë edhe mjetet më të domosdoshme. Peshku në det, tigani në zjarr fj. u. iron. shih te PESHK,~U.
- DËFTEJ** kal. Eja baba të të dëftej arat. fj. u. Gjarpri nuk i dëften këmbët. fj. u.
- DËFTOJ** kal. Qenit dëftoji shkopin. fj. u. Puna e dëfton njeriun. fj. u.
- DËGJOJ** kal. Fol pak e dëgjo shumë. fj. u. Koka që s'dëgjon, shumë pëson. fj. u. I bërtet së bijës, të dëgjojë e reja fj. u. shih te BËRTAS 3.
- DËM** m. Për një pe, për një gjilpërë, shkoi dëm një gunë e tërë. fj. u.
- DËSHTOJ** jokal. Kush nxiton, dështon. fj. u.
- DI** kal. Më mirë të dish se të kesh. fj. u.
E di gomari ku e vret samari fj. u. shih te GOMAR,~I. E di Gjoni ç'ka në trastë (në thes) fj. u. shih tek TRAST/Ë,~A,
E di luga se ç'ka vorba (vegshi, poçja) fj. u. shih te LUG/Ë,~A. E di mesit se ç'ka thesi fj. u. shih te MES,~I. I zoti e di ku i pikon çatia (shtëpia) fj. u. shih te ZOTI (i).
- DIELL** m. Dielli lind (ngroh) për të gjithë fj. u. secili ka të drejtë të jetojë i lirë, të gjithë kanë të drejtë ta gëzojnë jetën e tyre. Dielli duket (shihet) që në mëngjes (që kor lind) fj. u. duket që në fillim nëse një punë do të shkojë mirë, nëse diçka do të ecë mbarë ose nëse dikush do të jetë i mirë. Nuk lyhet (nuk fëlliqet) dielli me baltë fj. u. nuk përlyhet dot e vërteta e madhe (kur dikush përpiqet më kot ta bëjë këtë). Nuk mbulohet (nuk zihet, nuk fshihet) dielli me shoshë fj. u. nuk fshihet dot një gjë që është fare e qartë, e vërteta nuk mund të mbulohet (kur dikush përpiqet me kot ta bëjë këtë). Nuk zihet (nuk mbulohet) dielli me plisa fj. u. nuk mund të mbulohet një gjë shumë e madhe me diçka të vogël, nuk mund të fshihet diçka që shihet nga të gjithë; nuk mbulohet dielli me shoshë (kur dikush përpiqet më kot ta bëjë këtë). Dielli i mëngjesit të ngroh më mirë se i pasdrekes fj. u. duhet të punosh me këmbëngulje që kur je i ri; duhet ta rregullosh jetën që në moshë të re.
- DIGJEM** vetv. Kur m'u dogjën mullarët, njoha miqtë e kumbarët fj. u. shih te MULLAR,~I

- DIMËR** m. * Dimri ha beharin fj. u. prodhimet e verës harxhohen në dimër; ato që grumbullohen kur puna ecën mirë harxhohen në ditë të vështira.
- DITË** f. Dita e mirë duket që në mëngjes. fj. u.
S'ka dasmë çdo ditë (për ditë) fj. u. shih te DASM/Ë,~A. Dita ka sy e nata ka veshë fj. u. shih te VESH,~I. Kush ka ditën të mos presë mesditën fj. u. dita do shfrytëzuar që në mëngjes, s'duhet shtyrë puna për më vonë. S'shëndoshet (s'majmet) kau ditën që do të theret fj. u. shih te KA,~U.
- DJALË** m. Kush është djalë, në fushë të mejdanit duket. fj. u.
- DJALËRI** f. Kush s'mëson në djalëri, nuk gjen nder në pleqëri. fj. u.
- DJATHË** m. Kush ha djathë nga të hoxhës, pëlçet për ujë fj. u. shih te HOXH/Ë,~A.
- DJEG** kal. Kur ka mashën, pse të djegë dorën fj. u. shih te MASH/Ë,~A 2.
- DJEP** m. Më mirë djepin thatë (bosh) se shejtanin brenda fj. u.
- DORAS** m. E zunë dorasin. Me i keq gërgasësi se dorasi. fj. u.
- DORË** f. Nxjerr gështenjat nga zjarri me duart e botës. fj. u. S'bëhet dora topanxhë fj. u. shih tek TOPANXH/Ë,~A. Kapet qielli me dorë fj. u. shih te QIELL,~I. Nuk mbahen dy kunguj (dy shalqinj) në një dorë (nën një sqetull) fj. u. shih te KUNGULL, ~I. Kur ka mashën, pse të djegë dorën? fj. u. shih te MASH/Ë,~A 2. Njëra dorë lan tjetrën, të dy-ja lajnë fytyrën (faqet) fj. u. duke ndihmuar njëri-tjetrin bëhen mirë të gjitha punët. Mbaje (ruaje) zogun sa e ke në dorë! fj. u. shih te ZOG,~U. Asnjë s'të kruan si dora jote fj. u. shih te KRUAJ.
- DRAPËR** m. Nuk futet drapri në thes fj. u. e shtrembra ose gënjeshtira nuk mund të fshihen.
- DREJT** ndajf. Tymi të shkojë drejt, pa le të jetë oxhaku i shtrembër! fj. u. shih tek TYM,~I. Të rrimë shtrembër e të flasim drejt! fj. u. shih te SH TREMBËR.
- DREJTË** f. E drejta dërmon hekurin. fj. u. E drejta vonon, por nuk mungon. fj. u. E drejta rri si vaji mbi ujë. fj. u. e drejta fiton gjithnjë, e drejta nuk mund të mposhtet. E drejta i ka pemët te dera. fj. u. kush punon a vepron me drejtësi del gjithmonë i fituar.
- DREJTË** m. Me mirë fshikulli i të drejtit se llokumja e të shtrembrit. fj. u.
- DRITHË** m. Shiko drithin e jo thesin! fj. u. shiko veprat e jo fjalët, shiko punën e jo gunën.
- DRU** m. S'bëhet lundra me dru marene fj. u. shih te MAREN/Ë,~A. S'pritet druri (lisi) me një sëpatë (me një të rënë të sëpatës) fj. u. shih te SËPAT/Ë,~A. Druri ndreqet sa (kur) është i njomë fj. u. duhet të kujdesemi për edukimin e njerëzve që kur janë të mitur e të rinj.
- DRU** f. Kur shtie drutë, hap sytë! fj. u. shih te SH TIE. Një dru e shtrembër rrëzon (prish) gjithë stavën fj. u. shih te STAV/Ë,~A.
- DRUAJ** kal. Kush druan, vuan. fj. u.
- DUA** kal. Shkalla e lartë do këmbë të forta. fj. u. Derri do plumb. fj. u. Ajo kokë atë festë do. fj. u. Shpatullat duan këmbë fj. u. shih te SHPATULL,~A. Fshati që duket s'do kallauz fj. u. shih te FSHAT,~I.
- DUHI** f. Kush mbjell duhi, korr breshër e shi fj. u. Kush mbjell erën, korr furtunën.
- DUKEM** vetv. Miku i vërtetë duket në ditë të vështira. fj. u. Kapiteni i mirë duket në furtunë. fj. u. Dielli duket (shihet) që në mëngjes (që kur lind) fj. u. shih te DIELL,~I. Dita e mirë (moti i mirë) duket që në mëngjes fj. u. shih te MËNGJES, ~I. Fshati që duket s'do kallauz fj. u. shih te FSHAT,~I. Pula e botës duket më e majme iron. fj. u. shih

- te PUL/Ë,~A. Gjithkujt murrizi i vet i duket i njomë fj. u. shih te MURRIZ, ~I.
- DURIM** m. Me durim dhe me punë bëhet edhe shkëmbi vresht. fj. u.
- DURUAR** mb. I duruari, i fituari (i trashëguari). fj. u.
- DY** num. them. Nuk mbahen dy kunguj (dy shalqinj) nën një sqetull (në një dorë) fj. u. shih te KUNGULL,~I.
- DYFEK** m. vjet. S'të lënë topat të dëgjosh dyfekët fj. u. shih tek TOP,~I.
- DHASKAL** m. 1. vjet. Mësues. Kur s'ka mend djali, s'ka ç'i bën dhaskali. fj. u.
- DHE** I lidh. Sipas vendit dhe kuvendi. fj. u.
- DHE** II pj. Dhe të lodhur katër sy shohin prapë me mirë se dy. fj. u.
- DHEMB** jokal. E di ku i dhemb dhëmbi (dhëmballa) fj. u. e di vetë se për se ka me shumë nevojë a ku e ka pikën me të dobët; vetë e di ku e ka hallin, i zoti e di ku i pikon çatia. Ku dhemb dhëmbi, vete gjuha mendja të shkon a të rri tek ajo gjë që të shqetëson me shumë, për atë kërkon të flasësh.
- DHËMB** m. Me gojë të lan, me dhëmbë të çan fj. u. shih te LAJ. Kor s'ha kumbulla, s'të mpihen dhëmbët (dhëmballët) fj. u. shih te MPIHEM. Kush luan këmbët, luan dhëmbët fj. u. kush punon, ha.
- DHËMBALLË** f. Kur s'ha kumbulla, s'të mpihen dhëmballët (dhëmbët) fj. u. shih te MPIHEM.
- DHËNË** as. Dhënie. Udhë kalohet duke ecur, borxhi lahet me të dhënë. fj. u.
- DHËNË** mb. 1. Që i është dhënë dikujt për gjithnjë, i falur, i dhuruar. Gjëja e dhënë s'merret prapë ('kërkohet). fj. u.
- DHI** f. Dhia në malësi, delja në vërrin fj. u. secili duhet të qëndrojë në vendin e vet, gjithçka duhet vënë në vendin që i përket; secili duhet të gjejë vendin e tij në punë, në jetë sipas vetive e vlerave që ka. Gjej një herë bari, pastaj shko e bli dhi! fj. u. shih te BARI,~U.
- DHJAMË** m. S'del dhjamë nga pleshti fj. u. përçm.
- DHJES** jokal. * Atë që ul qafën, e dhjesin pulat fj. u. thjeshtligj. shih te PUL/Ë, -A.
- DHJETË** num. them. Mat dhjetë (tri, shtatë) herë e pre një herë fj. u. shih te MAT.
- DHURATË** f. Dhurata e armikut o helm o thikë. fj. u.
- DHUROHET** Pës. e DHUROJ. Liria nuk dhurohet, por fitohet me gjak. fj. u.
- EDHE** II lidh. 2. Gjithashtu, po ashtu, ashtu dhe. Si blea edhe mjalti. fj. u. Sipas vendit edhe kuvendi. fj. u. Edhe qeros, edhe fodull. fj. u. Edhe mishi të piqet, edhe helli të mos digjet. fj. u. Edhe të qorton edhe të do.
- EGJËR** f. Egjra prish edhe grurin. fj. u. një njeri i keq mund të prishë edhe të mirin. Nuk duhen lënë grurë e egjër bashkë. fj. u. duhet ndarë e mira nga e keqja.
- EHU** pasth. Ehu, sa miza janë, nuk bëjnë mjaltë! fj. u.
- ENDË** f. 3. Pjesa më e imët e më e mirë e miellit, majë mielli. I hedh endë. E bëjnë me endë. S'është as për endë as për miell. fj. u. nuk bën për asgjë, nuk vlen fare.
- ENË** f. Uthulla e fortë prish enën e vet fj. u. shih tek UTHULL,~A.
- EPEM** vetv. Me mirë të thyhesh, se sa të epesh. fj. u.
- ERË** I f. Fjalët i merr era fj. u. s'kanë vlerë fjalët, po që se nuk shoqërohen me vepra; fjalët harrohen shpejt. Kush mbjell erën do të korrë furtunën (stuhinë) fj. u. shih te MBJELL.
- ËMË** f. Po nuk qau fëmija, nuk i jep e ëma (nëna) sisë (gji, të pijë) fj. u. shih te QAJ.
- FALEM** vetv. Liria nuk falet, por fitohet me gjak. fj. u.
- FAQE** f. Njëra dorë lan tjetrën, të dyja lajnë faqet (fytirën) fj. u. shih te DQR/Ë,~A.

- FAQEBARDHË** mb. Puna është faqebardhë. fj. u.
- FERRË** f. Mbillte ferra nëpër këmbë. S'ka gardh pa ferra. fj. u.
Hardhia e bën rrushin, ferra e merr uratën fj. u. shih te **HARDHI**,~A.
- FESTE** f. * Sipas kokës edhe festen (ajo kokë atë feste do; atë kokë ka, atë feste do) fj. u. shih te **KOKË**,~A.
- FËLLIQEM** vetv. * Nuk fëlliqet (nuk lyhet) dielli me baltë fj. u. shih te **DIELL**,~I.
- FËMIJË** m. Shumë baba e mbytin fëmijën fj. u. shih te **BABO**,~JA. Po nuk qau fëmija, nuk i jep nëna (e ëma) sisë (gji, të pijë) fj. u. shih te **QAJ**.
- FIK** m. Nuk i hipën dot dardhës e i bie fikut fj. u. shih te **DARDH/Ë**,~A. Sheh fiku fikun (rrushi rrushin) e piqet fj. u. shih te **RRUSH**,~I.
- FIKUR** mb. 4. fig. Shumë i varfër, i këputur. Me mirë i fikur, se i koritur. fj. u.
- FILIZ** f. 2. Fidan druri ose bime. Shelgu ndreqet sa është filiz. fj. u.
- FJALË** f. Fjala është me e rëndë se plumbi. fj. u. Zihej (grindej, hahej) me fjalë. Fjala e burrit, pesha e gurit. fj. u. Burri lidhet prej fjalësh, kau (demi) prej brirësh. fj. u. Fjala ka këmbë. fj. u. Doli fjala nga dhëmballa, mori njëzet e shtatë mëhallë. fj. u. Fjalët i merr era fj. u. shih tek **ER/Ë**,~A I.
- FJALËGJATË** mb. 2. Përd. em. sipas kuptimit të mbiemrit. Fjalëgjati- punëthati. fj. u.
- FJALËRËNDË** mb. Me mirë memec se fjalërendë. fj. u.
- FJALËSHTRUAR** mb. 2. Përd. em. sipas kuptimit të mbiemrit. Fjalështruari - punëmbarruari. fj. u.
- FJALËSHUMË** mb. 2. Përd. em. sipas kuptimit të mbiemrit. Fjalëshumi - punëlumi. fj. u. kush flet shumë, punon pak e keq.
- FLAKË** f. Flaka të djeg, prushi të ngroh fj. u. shih te **PRUSH** ~I.
- FLAS** jokal. Kija inatin dhe foli hakun (kija matin po hakun mos ia ha) fj. u. shih tek **INAT**,~I. Të rrimë shtrembër e të flasim drejt! fj. u. shih te **SHTREMBËR**.
- FLE** jokal. Kush fle me qen, ngrihet me pleshta. fj. u. Macja që fle nuk zë dot minj. fj. u. Uji fle, hasmi s'fle. fj. u. Nuk fle (nuk kullot) delja me ujkun bashkë fj. u. shih te **DEL/E**,~JA. Kur fle (kur rri) koka, lëviz gjuha fj. u. shih te **KOK/Ë**,~A.
- FLOK** m. Humbi kokën e pyet për flokët fj. u. shih te **HUMB**.
- FORTË** mb. Shkalla e lartë do (kërkon) këmbë të forta fj. u. shih te **SHKALL/Ë**,~A. Uthulla e fortë prish enën e vet fj. u. shih tek **UTHULL**,~A. Myka e di sa e fortë është gozhda fj. u. shih te **MYK/Ë**,~A.
- FRYJ** kal. U dogj nga qulli (nga kungulli) e i fryn edhe kosit fj. u. shih te **QULL**,~I.
- FSHAT** m. Fshati që duket s'do kallauz fj. u. diçka që duket a njihet nuk ka nevojë për shpjegime të mëtejshme; është fare e qartë e nuk ka nevojë për ndonjë provë a dëshmi.
- FSHESË** f. Fshesa e re fshin më mirë. fj. u. Bëju fshesë shtëpisë sate! fj. u. secili duhet të shohë dhe të ndreqë më përpara të metat e veta, pastaj të qortojë të tjerët.
- FSHIHEM** I vetv. Nuk fshihet derri në thes fj. u. shih te **DERR**,~I. Nuk fshihet (nuk mbulohet, nuk zihet) dielli me shoshë fj. u. shih te **DIELL**,~I. Nuk fshihet (nuk hyn, nuk futet) hosteni (minarja) në thes fj. u. shih te **MINAR/E**, ~JA.
- FTOJ** kal. (në festival). Kush shkon paftuar, e gjen pa shtruar. fj. u.
- FUG** kal. Fug peshën e fsheh dorën fj. u. shih Hedh gurin e fsheh dorën te **HEDH**.
- FUKARA** m. bised. I pasuri s'e do (s'e kupton) fukaranë. fj. u.

- FUKARALLËK** m. bised. Varfëri. Fjalët e shumta janë fukarallëk. fj. u.
- FUNDIT** mb. Qesh mirë ai që qesh i fundit. fj. u. I fundit o qesh, o qan fj. u. shih te QAJ.
- FUQI** Me sa kam fuqi. Bashkimi bën fuqinë. fj. u.
- FURTUNË** f. Kush mbjell erën do të korrë furtunën (stuhinë) libr. fj. u. shih te MBJELL.
- FUSHË** f. Ku është fushë bëhet breg fj. u. vështirësi mund të lindin, kurdoherë mund të dalin pengesa. S'ka fushë pa breshkë fj. u. shih te BRESHK/Ë,~A. Fusha ka sy e mali (pylli, gardhi, muri) ka veshë fj. u. çdo gjë që të bësh e të thuash merret vesh.
- FUT** kal. Mos e fut në hambar pa e shoshitur fj. u. shih te SHOSHIT.
- FUTEM** vetv. Ku futet gjilpëra do të futet dhe peri fj. u. shih te PE,~RI.
- FYELL** m. S'bëhet dasma me një fyell fj. u. punët e mëdha nuk mund të bëhen vetëm nga një njeri, por kërkojnë bashkimin e forcave.
- FYT** m. Fyti është vëllai i detit fj. u. njeriu duhet të ketë masë në të ngrënë e në të pirë, përndryshe mund të shpenzojë tërë pasurinë, barku është pus pa fund. Kafshata e madhe të zë fytin fj. u. shih te KAFSHAT/Ë,~A. Luga e madhe të zë fytin (të shqyen gojën) fj. u. shih te LUG/Ë,~A. Thela e madhe të ngeç në fyt fj. u. shih te THEL/Ë,~A.
- FYTYRË** f. Me mirë të shkojë koka se fytyra fj. u. Dy gishta fytyrë ka njeriu nderi, emri i mirë është diçka kryesore, prandaj duhet ruajtur me kujdes të madh. Njëra dorë lan tjetrën, të dyja lajnë fytyrën (faqen) fj. u. shih te DOR/Ë,~A.
- GALDOJ** jokal. Kush punon, galdon. fj. u.
- GARDH** m. Mos bëj hop pa e kapërcyer (pa e hedhur) gardhin! fj. u. mos u gëzo përpara kohe! Fusha ka sy e gardhi (mali, pylli, muri) ka veshë fj. u. shih te FUSH/Ë,~A.
- GASTARE** f. Gastarja e thyer s'ngjitet më. fj. u. miqësia e prishur s'ndreqet më, s'bëhet më ashtu siç ishte.
- GATI** * Kujto (zër në gojë) qenin, bëj gati (rrëmbe) shkopin fj. u. shih te QEN,~I.
- GËNJESHTËR** f. Gënjeshtra i ka këmbët të shkurtra. fj. u. Gënjeshtra bën vegshin, por nuk ia vë kapakun. fj. u.
- GËRSHËRË** f. S'korret livadhi me gërshërë fj. u. shih te LIVADH,~I.
- GËZOJ** kal. Punove gëzove. fj. u. puna është burim të mirash e kënaqësie.
- GËZHDALLË** f. * S'bëhet urë e gëzhdalla fj. u. shih tek UR/Ë,~A I.
- GISHT** m. Lëpi mjaltin, po mos e ha gishtin! fj. u. shih te MJALT/Ë,~I. Mos e prek në bisht, se te ha në gisht! fj. u. shih te BISHT,~I. Zbukurim, stolisje. I ka hije godia. Me mirë një godi se nëntë bukuri. fj. u.
- GOJË** f. Marr frymë me gojë. Goja llap e shpina dap. fj. u. Çfarë ha goja, tregon boja. fj. u. Goja tret edhe malet fj. u. shih te MAL,~I. Me gojë të lan, me dhëmbë të çan fj. u. shih te LAJ. Këmbë për baltë, gojë për mjaltë fj. u. shih te BALT/Ë,~A. Luga e madhe të shlyen gojën (të zë fytin) fj. u. shih te LUG/Ë,~A. Shpjer gojën te buka e jo bukën te goja fj. u. shih te BUK/Ë,~A. Kujto (zër në gojë) qenin, rrëmbe (bëj gati) shkopin fj. u. shih te QEN,~I.
- GOMAR** m. S'çalon gomari nga veshët fj. u. shih te ÇALLOJ. Ia ha bukën E di gomari ku e vret samari fj. u. secili i di vetë punët e hallet e tij, e di i zoti ku i pikon çatia. Kali humbi, gomari s'duket fj. u. është rrëmujë e madhe, nuk e merr vesh i pari të dytin. Punon kali, ha gomari fj. u. shih te KAL/Ë,~I. I zoti e nxjerr (e qit) gomarin nga balta fj. u. shih te BALT/Ë,~A. S'ka ç'i bën gomarit, i

- bie samarit fj. u. ia nxjerr inatin jo atij që duhet, por dikujt tjetër që nuk ka faj, gjetkë e ka inatin e gjetkë e nxjerr. Kali ha tagjinë, gomari mbart bucelat fj. u. shih tek TAGJI,~A.
- GOZHDË** f. Për një gozhdë (thumb) shkoi (humbi) potkoi fj. u. shkoi dëm një gjë e madhe, me vlerë etj. për diçka të vogël, për hiçmosgjë; për një plesht u dogj jorgani. Myka e di sa e fortë është gozhda fj. u. shih te MYK/Ë,~A.
- GRIS** kal. Siç e nisi do ta grisë. fj. u. Gris (prish) gjirin, arno pëqirin! fj. u. thuhet kur dikush prish a dëmton një punë të madhe e të rëndësishme për të bërë diçka të vogël; prish bucela e bëj kënaçe.
- GRIZHËL** f. zool. Laraskë. Harron si grizhla çerdhen. fj. u.
- GROPË** f. Kush i bën gropën tjetrit, bie vetë brenda. fj. u.
- GRURË** m. bot. Kur s'ke grurë, e mirë është edhe thekra fj. u. shih te THEK/ËR,~RA. Thekra është e gjatë, po gruri hahet fj. u. shih te THEK/ËR,~RA.
- GRUSHT** m. Që në gusht nga një grusht fj. u. rezervat sigurohen duke i mbledhur me kohë, pak e nga pak; për të arritur përfundime të mira në një punë duhet filuar me kohë, duke punuar çdo ditë, pak e nga pak.
- GUNË** f. Mos i shiko gunën, po shikoj punën. fj. u. Rrëfen puna, s'rrëfen guna. Për një pe, për një gjilpërë, shkoi kot një gunë e tërë fj. u. shih te PE,~RI.
- GUR** m. Me një gur s'bëhet mur. fj. u. Gur, gur bëhet mur. fj. u. Gurë, gurë bëhet kalaja. fj. u. Pika shpon gurin. fj. u. S'del vaj nga guri fj. u. shih te VAJ,~I I. Gjuha pret hekurin (çan gurin, shkëmbin) fj. u. shih te GJUH/Ë,~A. S'ka oriz pa gurë fj. u. s'ka gjë pa asnjë të metë, s'ka pyll pa derra. Fjala e burrit, pesha e gurit fj. u. shih te PESH/Ë,~A. Guri është i rëndë në vend të vet fj. u. njeriu ka vlerë në vendin e tij. Një gur s'bën (s'çon) mur fj. u. një i vetëm nuk kryen dot punën që bëjnë shumë veta të bashkuar, bashkimi bën fuqinë.
- GUSHT** m. GUN/Ë,~A 1. Pa ardhur gushti, s'piqet mushti. fj. u. Shkoi vapa me gushtin fj. u.
- GUXOJ** jokal. Kush guxon, fiton. fj. u.
- GJAK** m. Gjaku s'bëhet ujë. fj. u. nuk mund të mohohen a nuk mund të zhduken lidhjet e afërta.
- GJALPË** m. Gjalpi në lakror bie (derdhet, mbetet) fj. u. shih te BIE I.
- GJALLESË** f. 2. Të qenët gjallë; të jetuarit, jetesë, jetë. Ku ka gjallesë, ka edhe shpresë. fj. u.
- GJARPËR** m. Gjarprit shtypi kokën! fj. u. për armikun mos ki mëshirë, armikun shfarose! Nuk i tregon gjarpri (bolla) këmbët fj. u. njeriu i lig a armiku mundohet t'i fshehtë synimet a qëllimet e këqija, është fsheharak.
- GJEJ** kal. Kush kërkon, gjen. fj. u. Gjej njëherë bari, pastaj shko e bli dhi. fj. u.
- GJELLË** f. Gjellë me kripë e kripa me karar fj. u. shih te KRIP/Ë,~A. Mos shtjer kripë në gjellë të botës! fj. u. shih te SHTIE.
- GJERBË** f. Zë gjerbat. Gjerba shpon gurin. fj. u.
- GJË** f. Çdo gjë që ndrit nuk është ar (flori). fj. u.
- GJË** Ku ka zë, s'është pa gjë. fj. u.
- GJËMIM** m. Qielli i kthjellët s'ka gjëmime. fj. u.
- GJËMOJ** I jokal. Nuk gjëmon po s'vetëtiu. fj. u.
- GJI** m. Po nuk qau fëmija, nuk i jep nëna (e ëma) gji. fj. u. Gris (prish) gjirin, arno pëqirin fj. u. shih te GRIS.
- GJILPËRË** f. S'bëhet pusi me gjilpëra fj. u. duhen mjetet e nevojshme për diçka, nuk bëhet një punë pa veglat e mjetet e nevojshme. Nuk humbi (s'u shua) pazari për gjilpëra fj. u. shih te HUMB. S'mbushet pusi me gjilpëra (me pështymë) fj. u. shih te PËSHTYM/Ë,~A. Ku futet

- gjilpëra do futet edhe peri fj. u. shih te PE,~RI. Për një pe, për një gjilpërë, shkoi dëm një gunë e tërë fj. u. shih te PE,~RI.
- GJITHË** pakuf. Dielli lind për të gjithë. fj. u.
- GJOK** m. 2. përd. mb. I bardhë nga thinjat. Koka gjok e mendja zog. fj. u.
- GJOKS** m. Armikut dhe erës treguju gjoksin. fj. u.
- GJU** m. Me mirë te pritet koka (kryet) se te thyhen gjunjët fj. u. më mirë të vdesësh me nder e ballëart sesa të rrosh i përulur e i nënshtruar.
- GJUHË** f. Gjuha është prej tuli fj. u. gjuha mund të thotë çdo gjë, gjuhën mund ta sjellësh e ta vërtitësh si të duash e të thuash ç'të duash, prandaj duhet të kesh kujdes kur flet. Gjuha pret hekurin (çan gurin, çan shkëmbin)fj. u. gjuha ka forcë të madhe. Gjuha gënjeshtare është llo-motare fj. u. kur dikush përpiqet të fshehtë të vërtetën, zakonisht flet shumë. Gjuha e ka rrënjën në zemër fj. u. shih te RRËNJ/Ë,~A. Më mirë të shkasë këmba se gjuha fj. u. fjalët që thuhet me rrëmbim e pa u menduar, mund të sjellin një dëm që nuk ndreqet lehtë. Kur rri (kur fle) koka, lëviz gjuha fj. u. shih te KOK/Ë,~A. Gjuha kocka s'ka e kocka thyen fj. u. gjuha ka fuqi të madhe, prandaj duhet përdorur me kujdes.
- GJUMË** m. Gjumi është vëllai i vdekjes fj. u.
- GJURMË** f. Unë them «ja ujk!» ti kërkon gjurmët (kur ke ujkun, mos i kërko gjurmët!) fj. u. shih tek UJK,~U.
- GJYSMË** f. Fillimi i mbarë është gjysma e punës. fj. u.
- HA** kal. Ha bukën e mikut, bën duanë e armikut. fj. u. Kur s'ke pulën, ha (edhe) sorrën. fj. u. Ç'i ha goja do t'ia tregojë boja. fj. u. Dimri ha beharin fj. u. shih te DIM/ËR,~RI. Çon një pelë e ha një thelë fj. u. shih te PEL/Ë, ~A. Kush ha bukë, bën edhe thërrime fj. u. shih te BUK/Ë, ~A. Po nuk hëngre hudhër, nuk bie erë fj. u. shih te HUDH/ËR,~RA. Kur s'ha kumbulla, s'të mpihen dhëmbët (dhëmballët) fj. u. shih te MPIHEM. Kur s'ke rrush, ha edhe larushk fj. u. shih te LARUSHK,~U. Qeni që le nuk të ha (nuk të kafshon) fj. u. shih te LEH. Qeni leh atje ku ha fj. u. keq. shih te QEN,~I.
- HAHEM** vetv. Kur hahen qentë, i ha ujku dhentë. fj. u.
Pema pa u pjekur s'hahet fj. u. shih te PEM/Ë,~A.
- HAK** m. bised. Kija inatin dhe foli hakun! (kija inatin, po hakun mos ia ha!) fj. u. shih tek INAT,~I.
- HALL** m. bised. Hall me buaj, hall me qe. fj. u.
- HALLALL** m. bised. Mos përziej hallallin me haramin. fj. u.
- HALLK** m. përmb. bised. Njerëzia, bota, njerëzit. Fjalët e hallkut e vrimat e gardhit s'mbyllen kurrë. fj. u.
- HAMBAR** m. Po shtire mizën (milingonën), të iku hambari fj. u. shih te SHTIE.
- HAMËS** mb. Është hamës i madh. Hamësi e ha kamësin fj. u. të ngrënët e të pirët jashtë mase e shkatërron ekonominë e shtëpisë.
- HAP** m. Bëje (mate, lëshoje) vrapin sa ke hapin fj. u. shih te VRAP,~I 3.
- HAP** kal. Kur shtie drutë, hap sytë! fj. u. shih te SHTIE.
- HAPSHKURTËR** mb. 2. Përd. em. sipas kuptimit të mbiemrit. Hapshkurtri ia kalon hapgjatit. fj. u.
- HAPSHPEJTË** mb. 2. Përd. em. sipas kuptimit të mbiemrit. Hapshpejti - këmbëlehti. fj. u.
- HARAM** m. bised. E hante bukën haram. Harami s'bëhet hallall. fj. u.
- HARDHI** f. bot. * Hardhia e bën rrushin, ferra merr uratën fj. u. thuhet kur punën e bën një njeri, ndërsa frytet i rrëmben një tjetër.

- HARROJ** kal. Ujku qimen ndërron, por zakonin s'e harron fj. u. shih tek UJK,~U.
- HASM** m. Ujët fle, hasmi s'fle. fj. u.
- HEKUR** m. Hekuri njihet në zjarr, miku në nevojë. fj. u. Gjuha pret hekurin (çan gurin, çan shkëmbin) fj. u. shih te GJUH/Ë,~A I. Hekuri rrihet sa është i nxehtë fj. u. çdo punë do bërë në kohën e vet, shpejt dhe asnjëherë të mos shtyhet për më vonë.
- HELM** m. Helmi e plak njeriun. fj. u. Më mirë shkelmi se helmi fj. u. shih te SHKELM,~I. Dhuratë e armikut o helm o thikë fj. u. e mira që të bën armiku sjell të këqija të mëdha, fsheh tradhti e pabesi, mos prit kurrë të mirë nga armiku.
- HELL** m. Mishi të piqet, helli të mos digjet. fj. u.
- HEQËS** IV m. Heqkeqës. Heqësi e di të keqen. fj. u.
- HEQKEQËS** m. Më mirë heqkeqës se grabitës. fj. u.
- HEQUR** mb. I hequri, i regjuri. fj. u.
- HERË** f. sh Matu shtatë herë dhe fol një herë. fj. u.
- HESAP** m. bised. Hesapi i shtëpisë nuk del në pazar fj. u.
- HESHT** jokal. Kush nuk di të heshtë, nuk di edhe të flasë. fj. u.
- HIJE** f. sh Lisit shihi hijen, njeriut shihi mendjen. fj. u. Shtat e hije, mend asnjë fije. fj. u.
- HIME** f. kryes. I shtrenjtë në hime, i lirë në miell. fj. u. i kursyer në gjëra të vogla e pa ndonjë vlerë të madhe dhe dorëlirë në gjëra të mëdha e me vlerë.
- HIP** jokal. Nuk i hipën dot dardhës e i bie fikut fj. u. shih te DARDH/Ë,~A.
- HIR** m. I ligu s'ka hir. fj. u.
- HISËLL** m. bot. krahin. Hithër. Mbjellin hisëll e duan të korrin grurë. fj. u.
- HITHËR** f. * Nuk bie reja (rrufeja) në hithra fj. u. mospërf. nuk bie e keqja mbi të keqin, s'vete e keqja tek i keqi.
- HOP** pasth. Mos bëj hop pa e kapërcyer (pa e hedhur) gardhin! fj. u. shih te GARDH,~I.
- HOSTEN** m. Nuk fshihesh dot prapa hostenit. fj. u. Nuk hyn (nuk futet, nuk fshihet) hosteni (minarja) në thes fj. u. shih te MINAR/E,~JA.
- HOXHË** m. sh Kush ha djathë nga të hoxhës, pëlçet për ujë fj. u. mos prit të mirë nga hoxha e nga prifti.
- HU** m. Nuk mbahet gardhi me një hu. fj. u. Ose hu ose thupër fj. u. ose i mirë, i fortë e me vlerë ose i keq, i dobët e pa vlerë.
- HUA** f. Nuk mbahet shtëpia me miell hua. fj. u.
- HUAJ** m. Më mirë të të rrahë yti, sesa të të puthë i huaji. fj. u.
- HUAJ** mb. Dora e huaj s'di të kruajë. fj. u. Kali i huaj (i botës) të lë në mes të udhës fj. u. shih te KAL/Ë,~I.
- HUDHËR** f. 2. fig. Njeri i lig, njeri i keq. Hudhra hudhrën do. fj. u. Po nuk hëngre hudhër nuk bie erë fj. u. po nuk pate bërë vërtet faj, nuk mund të të bëjnë fajtor.
- HULINË** f. 2. fig. Send a njeri pa vlerë, fundërrinë. Duhet ndarë kokrrat nga hulina. fj. u. duhet ndarë e mira nga e keqja ose i miri nga i keqi, duhet ndarë gruri nga egjra.
- HULLI** f. Kau i mirë njihet në hulli. fj. u.
- HUMB** kal. Në humbi unazat, gishtërinjtë i ka. fj. u. Për një gozhdë humb potkoi. fj. u. Për një gozhdë (thumb) humbi (shkoi) potkoi fj. u. shih te GOZHD/Ë,~A.. Nuk humbi ('u shua) pazari për gjilpëra. fj. u. nuk është gjë që s'e gjen dot, e vepron pa u menduar. Humbi kokën e pyet për flokët. fj. u. humbi qetë e pyet për brirët.
- HUMBAS** kal. dhe jokal. Kush pyet s'humbet. fj. u.

- HUNDË** f. Hunda në lis, morri në kurriz fj. u. mendjemadhësia sjell gjithmonë të këqija, mendja e madhe e zeza e të zotit.
- HUNDËPËRPJETË** mb. 3. Përd. em. sipas kuptimeve të mbiemrit. Hundëpërpjeti - mendjelehti. fj. u.
- HYJ** jokal. Ku hyn dielli nuk hyn mjeku. fj. u.
- HYZMEQAR** m. vjet. Shërbyes, shërbëtor. Më mirë qyqar se hyzmeqar. fj. u.
- IKI** jokal. Kur të ikën koka (kur të presin kokën), mos qaj për flokët fj. u. shih te KOK/Ë,~A 5. Iku nga shiu e ra në breshër fj. u. shih te SHI,~U. Iku nga tymi e ra në zjarr fj. u. shih te TYM,~I. Po shtire (fute) mizën (milingonën), të iku hambari fj. u. shih te SHTIE.
- INAT** m. bised. Inati- dëmi i kokës. fj. u.
- IND** I m. Pëlhurës këqyri indin dhe fëmijës prindin. fj. u.
- IRIQ** m. Nuk rri iriqi në plis fj. u. shih te PLIS,~I I.
- ISH** pasth. Kur s'ke pula, mos bëj ish! fj. u. shih te PUL/Ë,~A.
- JAKËZ** f. 2. Kapuç i madh në gunën e burrave; kapuç i gjatë i bërë me lesh dhie, që e hedh bariu në kokë kur bie shi; llabane. Guna pa jakëz si këmisha pa mëngë. fj. u.
- JAM** jokal. Tym i të shkojë drejt, pa le të jetë oxhaku i shtrembër! fj. u. shih tek TYM,~I.
- JAP** kal. Ç'jep, atë merr. fj. u.
I zoti e shet, tellalli s'e jep fj. u. shih te ZOTI (i). Atij s'i japin bukë, kërkon edhe gjellë shih te GJELL/Ë,~A. Po nuk qau fëmija, nuk i jep nëna (e ëma) sisë (gji, të pijë) fj. u. shih te QAJ. Nuk hahen ato petulla që t'i jep (t'i sjell) shigjetulla fj. u. shih te PETULL,~A.
- JASHTË** Mos e shih nga jashtë! fj. u.
- JATAGAN** m. Një mill s'i nxë dy jataganë fj. u. s'mund të bësh mirë disa punë njëkohësisht; s'mbahen dy kunguj në një sqetull.
- JETËGJATË** mb. Jetëgjati jetëshkurtër s'bëhet. fj. u.
- JETIM** mb. Faji është jetim fj. u. keq. përdoret kur askush nuk e pranon fajin, kur askush nuk i del zot fajit.
- JETOJ** jokal. Për një nder jeton njeriu. fj. u. Sa të jetosh, do të mësosh. fj. u.
- JORGAN** m. Bora është jorgani i bimës fj. u. bora e mbulon dhe e mban ngrohtë bimën. Për një plesht djeg jorganin fj. u. shih te PLESHT,~I. Shtriji (zgjati) këmbët sa ke jorganin (plafin shtratin) fj. u. shpenzo aq sa ke mundësi; vëri vetes detyra që ke aftësi e mundësi t'i kryesh.
- KA** m. Humbi qetë e pyet për brirët fj. u. shih te HUMB. Kjo është (kësaj i thonë) tre qe e dy pendë shih te PEND/Ë,~A II. S'shëndoshet (s'majmet) kau ditën që do të theret fj. u. s'lihet puna për në fund, s'arrihet përfundimi i dëshiruar duke punuar e duke u përpjekur vetëm në çastin e fundit.
- KAÇILE** f. S'bartet çorba me kaçile fj. u. shih te ÇORB/Ë, ~A.
- KAFSHATË** f. Kafshata e madhe të zë fytin fj. u. mos lakmo shumë se mund ta pësosh!
- KAFSHOJ** kal. Qeni që leh nuk kafshon fj. u. ai që të kërcënon shumë nuk është aq i rrezikshëm sa tregohet.
- KALA** f. Gur, gur bëhet kala fj. u. duke punuar çdo ditë e nga pak mund të bëhet një punë e madhe; gur, gur bëhet mur.
- KALB** kal. Pema e kalbur kalb (kalbëzon) edhe shoqet fj. u. shih te PEM/Ë,~A.
- KALBËZOJ** kal. Pema e kalbur kalbëzon (kalb) edhe shoqet fj. u. shih te PEM/Ë,~A.
- KALË** m. Kali nuk ka prask fj. u. shih te PRASK,~U. Kalë të preshtë nuk ka fj. u. shih te PRESHTË (i, e). Kali i mirë

- (i kuq) e ka një huq fj. u. çdo njeri, sado i mirë e i zoti që të jetë, e ka një të metë; kur dikush punon shumë mirë edhe ndonjë e metë që ka nuk i vihet re. Kali humbi, gomari s'duket fj. u. shih te GOMAR, ~I. Kali i mirë e shton (vetë) tagjinë fj. u. një njeri që punon, vlerësohet e nderohet gjithnjë e më shumë nga shoqëria. Kali i mirë njihet nën mutaf fj. u. shih te MUTAF, ~I. Kur t'i hipësh kalit, shihi potkonjtë fj. u. shih te POTK/UA, ~OI. Kali ha tagjinë, gomari mbart bucelat fj. u. shih tek TAGJI, ~A. Kali i botës (i huaj) të lë në mes të udhës fj. u. nuk duhet t'i varim shpresat tek të tjerët, por duhet të mbështetemi në forcat tona. S'mëson kali revan në pleqëri fj. u. shih te REVAN, ~I. Punon kali, ha gomari fj. u. thuhet kur punën e bën dikush, por prej saj përfitojnë të tjerët që s'e meritojnë.
- KALOHEM** S'kalohet jeta në vetmi. Deti më këmbë s'kalohet. fj. u.
- KALLAUZ** m. vjet. Fshati që duket s'do kallauz fj. u. shih te FSHAT, ~I.
- KALLI** m. Kalliri plot e mban kokën poshtë, kalliri bosh e mban përpyetë. fj. u.
- KAM** kal. Më mirë të dish sesa të kesh. fj. u.
- KAPAK** m. Gënjeshtër e bën vegshin, por nuk ia vë kapakun fj. u. shih te VEGSH, ~I.
- KAPEDAN** m. Kapedani i mirë njihet në furtunë. fj. u.
- KAPEM** vetv. S'kapet qielli me dorë fj. u. shih te QIELL, ~I. Nga peri mund të kapet edhe lëmshi fj. u. shih te PE, ~RI.
- KAPËRCEHEM** vetv. Buka pa gëlltitur nuk kapërcehet fj. u. nuk mund të zgjidhen çështjet pa punë e përpjekje; për t'ia arritur një qëllimi duhen bërë përpjekje të njëpasnjëshme.
- KAPËRCEJ** kal. Flet për uthullën e kapërcen tek qumështi fj. u. shih tek UTHULL, ~A.
- KAPITEN** m. Kapiteni i mirë njihet në furtunë. fj. u.
- KARAR** m. bised. Gjella me kripë e kripa me karar. fj. u.
- KARVAN** m. Qentë le të lehin, karvani shkon përpara. fj. u.
- KASOLLE** f. Prish shtëpi e bën kasolle fj. u. shih te SHTËPI, ~A.
- KEQE** f. As e mira as e keqja nuk duhen harruar. fj. u. Çdo e keqe s'vjen për të keqe. fj. u.
- KËMBË** f. Më mirë të vdesësh më këmbë, sesa të rrosh më gjunjë. fj. u. Kush luan këmbët, luan edhe dhëmbët. fj. u. kush punon e siguron jetesën, kush punon ha. Çdo berr varet nga këmbët e veta. fj. u. shih te BERR, ~I. Kush s'ka kokë, ka këmbë. fj. u. Deti s'kalohet me këmbë fj. u. shih te DET, ~I. Fjala ka këmbë fj. u. nëse thuhet diçka nuk mund të mbahet e fshehtë, fjala përhapet. Shpatullat duan këmbë fj. u. shih te SHPATULL, ~A. Nuk i tregon gjarpri (bolla) këmbët fj. u. shih te GJARP/ËR, ~RI. Çdo berr varet nga këmbët e veta fj. u. shih te BERR, ~I. Gënjeshtër i ka këmbët të shkurtra fj. u. shih te SHKURTËR (i,e). Këmbët për baltë, gojë për mjaltë fj. u. shih te BALT/Ë, ~A. Kush luan këmbët, luan dhëmbët fj. u. shih te DHËMB, ~I.
- KËNDOJ** I kal. S'këndon zhaba në të thatë fj. u. shih te ZHAB/Ë, ~A.
- KËNGË** f. Disa jashtë valles dinë shumë këngë fj. u. shih te VALL/E, ~JA.
- KËPUTEM** vetv. Peri këputet ku është i dobët. fj. u.
- KËRCEJ** jokal. Po hyre në valle, duhet të kërcesh fj. u. shih te VALL/E, ~JA.
- KËRKOJ** kal. Kush kërkon, gjen. fj. u. Ujku mjegull kërkon. fj. u. Kush kërkon copën e madhe, humbet edhe të voglën. fj. u.
- KËSMET** m. bised. Kësmeti është në dorë të njeriut. fj. u.

- KOBURE** f. Koburja bosh tremb dy veta fj. u. koburja boshe tremb edhe atë që e mban (se e di që është bosh e nuk e vret dot tjetrin) edhe atë tjetrin (që nuk e di se koburja është bosh).
- KOCKË** f. Mish pa kocka s'ka. fj. u. Gjuha kocka s'ka e kocka thyen. fj. u. Kocka e thatë nuk lëpihet fj. u. mos kërko aty ku nuk ka gjë prej gjëje, s'ke ç'merr aty ku s'ka gjë.
- KOHË** f. Koha është flori. fj. u. Koha e mirë duket që në mëngjes. fj. u. Kroi (pusi) i mirë njihet në kohë të thatë fj. u. shih te KRUA, KROI. Shkoftë kohë e shkoftë mot, e vërteta del në not fj. u. shih te VËRTE/Ë,~A (e).
- KOKË** f. Koka bën koka pëson. fj. u. Kush s'ka kokë, ka këmbë. fj. u. Koka që s'dëgjon, më shumë e pëson. fj. u. I ra një hall i madh mbi kokë. Rrit gjarprin të të hajë kokën. fj. u. Koka e falur nuk pritet. fj. u. S'i bihet malit me kokë (me krye) fj. u. shih te MAL,~I. S'i bihet murit me kokë fj. u. shih te MUR,~I. Gjarprit shtypi kokën! fj. u. shih te GJARP/ËR, ~RI. Te koka e qerosit të gjithë bëhen berberë fj. u. shih te QEROS,~I. Bie miu e thyen kokën shih te THYEJ. Humbi kokën e pyet për flokët fj. u. shih te HUMB. Sipas kokës edhe festen (ajo kokë atë festë do; atë kokë ka, atë feste do) fj. u. mirë e gjeti, mirë e pësoi! (thuhet për dikë që bën një veprim të pamenduar a të gabuar, i cili i sjell pasoja të hidhura). Nga lëviz qafa, kthehet koka fj. u. shih te QAF/Ë,~A. Më mirë të pritet koka (kryet) se të thyhen gjunjët fj. u. shih te GJU,~RI. Më mirë të të shkojë koka (kryet) se fytyra fj. u. shih te KRYE,~T. Kur rri (kur fle) koka, lëviz gjuha fj. u. kur njeriu nuk i mendon e nuk i peshon gjërat mirë, gjuha s'ka fre dhe flet mbarë e prapë. Zure bollën, shtypi kokën fj. u. shih te BOLL/Ë,~A.
- KOKËRR** f. Sa thana janë kokrra s'bëjnë fj. u. shih te THAN/Ë,~A.
- KOKOSH** m. 1. Këndes, gjel. Dy kokoshë në një pleh nuk qëndrojnë. fj. u.
- KOPRRAC** m. As gurë s'të jep koprraci. fj. u.
- KORB** m. Korbi korbit (sorra sorrës) s'ia nxjerr sytë fj. u. i ligu nuk i bën keq të ligut.
- KORR** kal. Ç'të mbjellësh do të korrësh. fj. u. Kush mbjell erën, korr furtunën. fj. u.
- KORRET** Pës. S'korret livadhi me gërshërë fj. u. shih te LIVADH,~I.
- KORRIK** m. Shiu në korrik, misri me shinik. fj. u.
- KOS** m. U dogj nga qulli (nga kungulli) e i fryn edhe kosit fj. u. shih te QULL,~I.
- KRIPË** f. Ç'bën në det e gjen në kripë fj. u. shih te DET,~I. Gjella me kripë e kripa me karar fj. u. çdo punë ka një kufi, i cili nuk duhet kaluar; në çdo gjë duhet ruajtur masa. Mos shtjer kripë në gjellën e botës! fj. u. shih te SHTIE.
- KROI** m. Kroi (pusi) i mirë njihet në kohë të thatë fj. u. në rrethana të vështira njihet njeriu i mirë e i zoti ose miku i vërtetë.
- KRUA** m. Kroi (pusi) i mirë njihet në kobë të thatë fj. u. në rrethana të vështira njihet njeriu i mirë e i zoti ose miku i vërtetë.
- KRUAJ** kal. Asnjë s'të kruan si dora jote fj. u. asnjë s'ta bën dot shërbimin ashtu siç ia bën njeriu vetes; secili duhet të përpiqet që punës së vet t'i dalë zot vetë.
- KRUNDE** f. vet. Mos u përziej me krundet, se do të të hanë pulat (po të përzihesh me krundet, të hanë pulat) fj. u. po u ngatërrove me njerëz të këqij, do të gjesh belanë.
- KRYE** as. Më mirë të shkojë kryet (koka) se fytyra fj. u. më mirë të vdesësh se sa të humbasësh nderin a emrin e mirë.
- KTHEHEM** vetv. Shkoi (vajti) për lesh e u kthye (doli, erdhi) i qethur fj. u. iron. shih te LESH,~I. Nga lëviz qafa, kthehet koka fj. u. shih te QAF/Ë,~A.
- KTHEJ** kal. Një vijë nuk e kthen lumin prapa fj. u. shih te LUM/Ë,~I.

- KUJTOJ** kal. I ngopuri s'e kujton të uriturin. fj. u. Kujto mikun, ther dashin! fj. u. Kujto (zër në gojë) qenin bëj gati shkopin! fj. u.
- KULAÇ** m. Po u thye kulaçi, s'ngjitet më fj. u. po u prishe keq me dikë, është vështirë të kesh me të miqësinë e mëparshme.
- KULLOT** kal. Në fushë pa zot gjithë bota kullot. fj. u. Delja ku kullot, atje lë leshin. fj. u.
- KUMBARË** f. etnogr. Kur m'u dogjën mullarët, njoha miqtë e kumbarët fj. u. shih te MULLAR,~I.
- KUMBULL** f. Kur s'ha kumbulla, s'të mpihen (dhëmballët) fj. u. shih te MPIHEM.
- KUNGULL** m. U dogj nga kungulli (nga qulli) e i fryn edhe kosit. fj. u. shih te QULL,~I. Nuk mbahen dy kunguj (dy shalqinj) nën (një) sqetull (në një dorë) fj. u. nuk mund të bëhen shumë punë përnjëherësh, nuk duhet të zotohesh për të bërë vetë shumë punë që nuk i kryen dot. Nuk shkon gjithmonë kungulli mbi ujë fj. u. nuk i ecin gjithmonë dallaveret që bën, nuk mund t'ia hedhë gjithmonë të tjerëve, do t'i dalin të palarat në shesh një ditë.
- KUR** Kur hahen qentë, i ha ujku dhentë. fj. u. Kur s'ke shok, pyet shkopin. fj. u. Kur s'ke gunën, shtro kësulën. fj. u. Mulliri bluan, kur ka ujë. fj. u.
- KURSEJ** kal. Kush punon e kursen, gëzon e dëfren. fj. u.
- KURRË** ndajf. Më mirë vonë se kurrë. fj. u.
- KUSAR** m. Kusari kusarit s'i vjedh dot. fj. u. Vë kusarin të ruajë shtëpinë. fj. u.
- KUSI** f. Kusia mbi prush, thëllëza në fushë fj. u. peshku në det, tigani në zjarr. Lepuri në mal e vala (kusia) në zjarr fj. u. shih te LEPUR,~I.
- KUSH** Kush punon, ha. fj. u. Kush s'ka mend, ka këmbë. fj. u. Kush bën, pëson. fj. u. Kush të rrojë, do të shikojë. fj. u. Kush kërkon, gjen. fj. u.
- KUVEND** m. Sipas vendit bëhet kuvendi fj. u. duhet vepruar në përshtatje me rrethanat a me vendin ku ndodhesh.
- LAGUR** mb. 4. Përd. em. sipas kuptimit 1 të mbiemrit. I laguri nga shiu s'trembet nga breshri. fj. u. S'ka ç'i bën shkëndija eshkës së lagur (së njomë) fj. u. shih te SHKËNDIJ/Ë,~A.
- LAJ** kal. Me gojë të lan, me dhëmbë të çan fj. u. shtihet i mirë, por të bën të keqen. Njëra dorë lan tjetrën, të dyja lajnë fytyrën (faqet) fj. u. shih te DOR/Ë,~A.
- LAJKËS** m. keq. Lajkatar. Lajkësi me gojë të lan e me dhëmbë të çan. fj. u.
- LAKROR** m. gjell. Gjalpi në lakror bie (derdhet, mbetet) fj. u. shih te BIE I.
- LARASKË** f. zool. Ka mbetur laraskë pa bisht fj. u. nuk mbetet njeri pa u rregulluar (i thuhet dikujt që duhet a përgatitet të marthet). Zihen (grinden) për të bardhat e laraskës shih te BARDH/Ë,~A (e).
- LARË** mb. Një e larë vlen sa një e ngrënë. fj. u. E lara dhe e ngrëna shkojnë bashkë. fj. u.
- LARG** Larg sysh, larg zemrës fj. u. shih te SY,~RI.
- LARTË** mb. Shkalla e lartë do (kërkon) këmbë të forta fj. u. shih te SHKALL/Ë,~A.
- LARTËSOJ** kal. Puna e lartëson njeriun. fj. u.
- LARUSHK** m. Kur s'ke rrush, ha edhe larushk fj. u. kur s'ke pulën, ha edhe sorrën.
- LAVDËRUAR** mb. 2. Përd. em. sipas kuptimit të mbiemrit. I duruari, i lavdëruari. fj. u.
- LEH** jokal. Qeni leh atje ku ha fj. u. keq. shih te QEN,~I. Qeni që leh nuk të ha (nuk të kafshon) fj. u. ai që të kanoset me fjalë të shumta nuk ka fuqi të të dëmtojë, mos ki frikë nga ai që ka shumë fjalë. Qentë le të lehin, karvani shkon përpara fj. u. armiqtë le të flasin e të shpifin sa të duan, ne s'bëhemi merak, por punojmë e përparojmë.

- LEJ** jokal. Ç'len prej maces (ç'pjell macja), gjuan minj fj. u. keq. shih te MAC/Ë,~JA. Djali pa lerë e djepi (fes-tja) blerë iron. shih Peshku në det, tigani në zjarr te PESHK,~U.
- LEK** m. Lakmia për lekun e prish njeriun. fj. u.
- LEPUR** m. Lepuri i madh rri në ferrë të vogël. fj. u. S'bëhet stan me lepuj fj. u. shih te STAN,~I. Lepuri në mal e vala (kusa) në zjarr fj. u. iron. peshku në det e tigani në zjarr.
- LESH** m. Shkoi (vajti) për lesh e doli (u kthye, erdhi) i qethur fj. u. iron. shkoi për të fituar, po humbi edhe atë që kishte pasur; vajti për t'i kërkuar llogari dikujt, po i kërkuan llogari atij vetë dhe e vunë përpara. Delja ku kullot, atje lë leshin fj. u. shih te DEL/E,~JA.
- LESH** as. Leshtë e ujkut, thonjtë e bufit fj. u. shih tek UJK,~U I.
- LESHNIK** I m. Hëngre fikun, vish leshnikun. fj. u.
- LË** kal. Punën e sotme mos e lër për nesër! fj. u. Kali i botës (i huaj) të lë në mes të udhës fj. u. shih te KAL/Ë,~I.
- LËKURË** f. Shkurti shkurton urët, marsi rrjep lëkurët. fj. u. S'dalin dy lëkurë nga një dele (nga një berr). fj. u. nuk duhet kërkuar nga një njeri më tepër se sa janë mundësitë. Ç'i bën dhia, shqemes, shqemja ia bën lëkurës fj. u. shih te SHQEM/E,~JA.
- LËMASHK** m. 1. bot. Lëmyshk. Lëmashku bren gurin, përtimi fik burrin. fj. u.
- LËMË** m. Në lëmë të grurit (të rakisë, të ullinjve, të pemëve). Puno sot e paratë në lëmë. fj. u.
- LËMISHTË** f. S'mbahet zjarri me lëmishte. fj. u.
- LËMOSHË** f. Më mirë një kokërr me djersë se një thes lëmoshë. fj. u. Lëmosha e ka helmin brenda. fj. u.
- LËMSH** m. Nga peri mund të kapet edhe lëmshi fj. u. shih te PE,~RI.
- LËMUAR** ndajf. Nuk rri lëmuar kush ka këmbë e duar. fj. u.
- LËPIJ** kal. Lëpi mjaltin po mos e ha gishtin! fj. u. shih te MJALT/Ë, ~I.
- LËSHOJ** kal. Kati i huaj të lëshon në ujë. fj. u.
- LËVDOHEM** vetv. Mikut ankoju, armikut lëvdoju. fj. u.
- LËVDUAR** mb. 2. Përd. em. sipas kuptimit të mbiemrit. I duruari, i lëvduari. fj. u.
- LËVIZ** kal. Nga lëviz qafa, kthehet koka fj. u. shih te QAF/Ë,~A. Kur rri (kur fle) koka, lëviz gjuha fj. u. shih te KOK/Ë,~A.
- LIDH** kal. Sa lule çelin, të gjitha nuk lidhin. fj. u.
- LIDHEM** vetv. Koha s'lidhet me litar fj. u. nuk mund të pengohet zhvillimi dhe përparimi i diçkaje, asgjë nuk qëndron në vend, por ecën përpara.
- LIMË** f. Lima e butë të ha trutë fj. u. thuhet për një njeri që vepron pa u ndjerë e ngadalë dhe të bën të keqën.
- LIMON** m. S'prishet dasma për një limon (për një qepë) fj. u. shih te DASM/Ë,~A.
- LIND** jokal. Kanë lindur qengjat e parë. S'ka lindur njeri i nxënë (i mësuar). fj. u. Nuk lind njeriu (burri) me mustaqe. fj. u. Dielli lind për të gjithë. fj. u. Dielli duket që kur lind. fj. u. Nga e vogla lind e madhja (e vogla lind të madhen). fj. u.
- LIRË** mb. I lirë në fjalë, i shtrënguar në hesap. fj. u. I lirë në miell, i shtrenjtë në krunde. fj. u. shih te KRUNDE,~T.
- LIRI** I f. Liria i ka rrënjët në gjak. fj. u. Liria nuk dhurohet, por fitohet. fj. u. Liria nuk mbrohet me fjalë e me urata, por me harqe e me shpata. fj. u.

- LIS** m. Sa më i gjatë është lisi, aq më shumë e zë era. fj. u.
Rigoni s'bëhet lis fj. u. shih te RIGON, ~I. S'pritet lisi (druri) me një sëpatë (me një të rënë të sëpatës) fj. u. shih te SËPAT/Ë, ~A.
- LITAR** m. Nuk drejtohet litari (tërkuza, konopi) në thes fj. u. shih te THES, ~I. Koha s'lidhet me litar fj. u. shih te LIDHEM. Mos hyr në pus me litarin e botës! fj. u. shih te PUS, ~I. Kur s'ke shkallën, merr litarin! (është i mirë edhe litari)! fj. u. shih te SHKALL/Ë, ~A. Në shtëpinë e të varurit nuk e zënë në gojë litarin fj. u. shih te VARUR (i, e).
- LIVADH** m. S'korret livadhi me gërshërë fj. u. s'bëhet një punë pa pasur mjetet e nevojshme.
- LODHEN** vetv. Po nuk u lodhe sot, do të mundohesh mot. fj. u.
- LOPATË** f. S'bëhet vreshti me urata, po me shata e me lopata. fj. u.
- LOPË** f. Lopa në mal, përseshi në vatër (në xham) fj. u. peshku në det, tigani në zjarr.
- LUAJ** jokal. Muri luan, burri s'luan. fj. u.
Kush luan këmbët, luan edhe dhëmbët. fj. u.
- LUFTOJ** jokal. Kush s'lufton, nuk fiton. fj. u.
- LUGAT** m. Vampiri e njeh lugatin fj. u. shih te VAMPIR, ~I.
- LUGË** f. Nuk thahet (nuk soset) deti me lugë fj. u. shih te DET, ~I. E di luga se ç'ka vorba (vegshi, poçja) fj. u. e di i zoti ku i pikon shtëpia. Luga e madhe të zë fytin (të shqyen gojën) fj. u. mos lakmo shumë se të del keq më pas! Atje ku bëhet dasmë e madhe, merr lugë të vogël! fj. u. atje ku bëhet diçka me bujë e me zhurmë të madhe, nuk del gjë; mos u gënje nga zhurma e nga buja! Ku të tregojnë copën e madhe merr lugën e vogël! fj. u. kur të lëvdojnë tepër diçka, mos prit shumë prej saj! Luga mbush barkun, piruni than gurmazin fj. u. për t'u ngopur mirë duhen gjellë të ngrohta e jo vetëm gjëra të thata.
- LUGË-LUGË** ndajf. Lugë-lugë shpiket një kupë. fj. u.
- LULE** f. Nuk lidhin të gjitha lulet. fj. u. Me një lule (me një dallëndyshe) s'vjen pranvera (behari) fj. u. nuk mjafton vetëm një njeri a një send për të bërë një punë të madhe, për t'ia arritur së mirës.
- LUMË** m. Pika-pika bëhet lumi fj. u. shih te PIKA-PIKA. Një vijë nuk e kthen lumin prapa fj. u. diçka e vogël s'mund të ndryshojë rrjedhën e përgjithshme të zhvillimit.
- LUNDËR** I f. S'bëhet lundra me dru marene fj. u. shih te MAREN/Ë, ~A.
- LYHEM** vetv. Nuk lyhet (nuk fëlliqet) dielli me baltë fj. u. shih te DIELL, ~I.
- LYP** kal. Po lyppte bagëtinë në mal. Kush lyp gjen. fj. u. Kush lyp copën e madhe, e humbet edhe të voglën. fj. u.
- LLOMOTAR** mb. Gjuha gënjeshtare është llo-motare. fj. u. shih te GJUHE, ~A I 1.
- LLUM** m. Llumi lahet, turpi s'lahet. fj. u.
- MACE** f. Dy mace mundin një qen (një luan, një ari). fj. u. Iku macja, lozin minjtë. fj. u.
LËKUR/Ë, ~A. S'bën macja mullar fj. u. shih te MULLAR, ~I. Ç'len prej maces (ç'pjell macja), gjuan minj fj. u. keq si është prindi, ashtu është edhe fëmija (thuhet kur fëmija ndjek rrugën e gabuar të prindit ose merr veset e tij). Macja lëpiu (lëmon) gjithnjë bishtin e vet fj. u. thuhet kur dikush lavdëron vazhdimisht punën e vet; shoshari shoshën e tij lëvdon.
- MAÇOK** m. Maçoku plak kërkon minj kërthinj. fj. u.
- MADH** mb. I vogël për prehër, i madh për zemër fj. u. shih te PREH/ËR, ~RI. Luga e madhe të zë fytin (të shqyen gojën) fj. u. shih te LUG/Ë, ~A. Thela

- e madhe të ngec në fyt fj. u. shih te THEL/Ë,~A.
- MAJ** I m. Nuk ka kokë dëborë në maj fj. u. nuk qëndron gjatë, shkrin shpejt. Shkëndijat (shkëndijëzat) dalin në maj fj. u. shih te SHKËNDIJ/Ë,~A.
- MAJË** f. Pa hipur në majë nuk mund të shohësh luginën. fj. u. S'vihen dy gjilpëra majë më majë fj. u. shih te GJILPËR/Ë,~A. Nuk ka majë pa rrëzë fj. u. shih te RRËZ/Ë,~A I. Një thumb njëqind herë ta rrahësh, një majë nxjerr fj. u. shih te THUMB,~I.
- MAJMEM** vetv. S'majmet (s'shëndoshet) kau ditën që do të theret fj. u. shih te KA,~U.
- MAJMË** mb. Pula e botës duket më e majme fj. u. iron. shih te PUL/Ë,~A.
- MAL** m. Mali me malin nuk piqet, njeriu me njeriun piqet. fj. u. Goja tret edhe malet fj. u. sado i pasur që të jesh, po u dhe në mënyrë të shfrenuar pas të ngrënave e pas të pirave, mund të mbetesh pa gjë fare. Lepuri në mal e vala (kusia) në zjarr fj. u. iron. shih te LEPUR,~I. U mbars mali e polli një mi fj. u. përdoret kur thuhet shumë fjalë të mëdha ose jepen shumë premtime, por në të vërtetë bëhet pak punë. Fusha ka sy e mali (pylli, gardhi, muri) ka veshë fj. u. shih te FUSH/Ë,~A. Kur s'ke ara në mal, pse bën dava me çakejtë? fj. u. shih tek AR/Ë,~A.
- MAN** m. bot. Pritëm për mana e na dolën thana. fj. u.
- MANASTIR** m. Sa më afër fshatit të jetë manastiri, aq më të varfër janë fshatarët. fj. u.
- MARENË** f. bot. S'bëhet lundra me dru marene fj. u. s'vlen për një punë të caktuar, s'bëhet bukë me krunde (për një njeri ose për diçka pa vlerë).
- MARTOHEM** vetv. Kush u martua e s'u gëzua! fj. u.
- MARR** kal. Fjalët i merr era fj. u. shih tek ER/Ë,~A I.
- MARRË** m. Një i marrë hedh një gur në pus, njëqind të mençur s'e nxjerrin dot. fj. u.
- MASHË** f. Mashë prej druri s'bëhet. fj. u. Kur ka mashën, pse të djegë dorën? fj. u.
- MAT** kal. Mat tri (shtatë, dhjetë) herë e prenë një herë! fj. u. mendohu shumë mirë para se të bësh një punë a veprim.
- MATEM** vetv. Iu mat me pëllëmbë. Më mirë t'i biesh se t'i matesh. fj. u. Matu dhjetë herë e vepra një herë! fj. u.
- MBAHEM** vetv. Nuk mbahet shtëpia me miell hua. fj. u.
- MBAJ** kal. Shtëpinë shite, shokun mbaje! fj. u. shih te SHES. Mbaje (ruaje) zogun sa e ke në dorë! fj. u. shih te ZOG,~U.
- MBARSEM** vetv. Nuk mbarset mushka të pjellë mëz fj. u. shih te MUSHK/Ë,~A.
- MBES** jokal. S'ka mbetur laraskë pa bisht fj. u. shih te LARASK/Ë,~A.
- MBETEM** vetv. Gjalpi në lakror mbetet (derdhet, bie) fj. u. shih te BIE I.
- MBIN** jokal. Duket bima që kur mbin fj. u. shih te BIM/Ë,~A.
- MBJELL** kal. Kush mbjell erën, do të korrë furtunën (stuhinë) fj. u. libr. kush bën një të keqe, do ta pësojë nga një e keqe më e madhe.
- MBLIDHEM** vetv. U derdh vaji, s'mblidhet më fj. u. shih te VAJ,~I. S'mblidhen pleshtat në grusht (s'futen pleshtat në thes) fj. u. shih te PLESHT,~I.
- MBRAPSHT** ndajf. Rri mbrapsht e fol drejt! fj. u.
- MBULOHEM** vetv. Nuk mbulohet (nuk zihet, nuk fshihet) dielli me shoshë fj. u. shih te DIELL,~I.
- MBULOJ** kal. Si të shtrosh, ashtu të mbulojnë fj. u. shih te SHTROJ.
- MBUSH** kal. Luga mbush barkun, piruni than gurmazin fj. u. shih te LUG/Ë,~A.
- MBUSHEM** vetv. S'mbushet pusi me pështymë (me gjilpëra) fj. u. shih te PËSHTYM/Ë,~A.

- MBYT** kal. Edhe vau të mbyt fj. u. shih te VA,~U. Shumë babo e mbytin fëmijën fj. u. shih te BABO,~JA.
- MBYTUR** m. I mbyturi s'ka frikë se laget. fj. u. Kapet si i mbyturi pas flokëve të vet. fj. u.
- ME** Shkoi vapa me gushtin. fj. u.
- MEKANIKË** f. Rregulla e artë e mekanikës fj. u. shih tek ARTË (i, e).
- MELHEM** m. bised. Fjala e mirë - melhem në zemër. fj. u.
- MENÇUR** mb. 4. Përd. em. sipas kuptimeve. I mençuri e kupton vetë. fj. u.
- MENÇURI** f. Trimëria pas luftës dhe mençuria pas kuvendit nuk vlejnë më fj. u.
- MENDJE** f. Mendja e madhe e zeza e të zot fj. u. mendjemadhi e pëson vetë. Mendja e madhe ta thyen qafën (zverkun) fj. u. mendja e madhe e zeza e të zot.
- MENDJEMADHËSI** f. E keqja nuk vjen nga urtësia, po nga mendjemadhësia. fj. u.
- MENDOJ** jokal. Mendo dhjetë herë e fol një herë! fj. u.
- MES** m. E di mesi se ç'ka thesi fj. u. çdo njeri i di më mirë vetë punët a hallet e tij.
- MESDITË** f. Ana e mesditës jugu. Kush ka ditën, të mos presë mesditën fj. u. shih te DIT/Ë,~A.
- MËLÇI** f. Për mëlçi ther kaun. fj. u. për një punë a gjë të vogël, prish një punë a gjë të madhe.
- MËMË** f. Përtacia është mëma e shumë të këqijave. fj. u.
- MËNGOJ** jokal. Kush mëngoi, bloi. fj. u.
- MËNGJES** m. Dielli duket (shihet) që në mëngjes (që kur lind) fj. u. shih te DIELL,~I. Dita e mirë (moti i mirë) duket që në mëngjes fj. u. vlerat, anët e mira të dikujt a të diçkaje duken që në fillim, se si do të jetë dikush a diçka duket që në krye.
- MËNOJ** jokal. bised. Vonohem. E drejta mënon, po nuk harron. fj. u.
- MËSOHEM** vetv. Kush është mësuar, s'ka të pushuar. fj. u.
- MËSOJ** kal. Sa të rrosh, do të mësosh. fj. u. Të mësojmë duke punuar dhe të punojmë duke mësuar. fj. u. S'mëson kali revan në pleqëri. fj. u. Hajde, baba, të të mësoj arat! fj. u. iron.
- MËZ** m. Nuk mbarset mushka të pjellë mëz fj. u. shih te MUSHK/Ë,~A.
- MI** m. U mbars mali e polli një mi fj. u. shih te MAL,~I. Ç'len prej maces (ç'pjell macja), gjuan minj fj. u. keq. shih te MAC/E,~JA.
- MIELL** m. Nuk mbahet shtëpia me miell hua. fj. u. I lirë në miell, i shtrenjtë në krunde fj. u. nuk kursen aty ku duhet. Guri që punon shtruar bën miell të butë fj. u. shih te SHTRUAR.
- MIK** m. Miku i mirë njihet në të vështirë. fj. u. Më mirë një mik (besnik), se një çiflig. fj. u. Mikut ankoju, armikut lëvdoju. fj. u. Më mirë pa miq, se me miq të ligj. fj. u. Kur m'u dogjën mullarët, njoha miqtë e kumbarët. fj. u. Hekuri njihet në zjarr, miku në nevojë. fj. u. Si miku edhe lakrori (sofra).fj. u. Si është miku bëhet petaniku. fj. u. Mikun prite e nderoje, po mos e bëj zot shtëpie! fj. u.
- MILINGONË** f. zool. Po shtive milingonën (mizën), të iku hambari fj. u. shih te SHTIE.
- MILL** m. Një mill s'i nxë dy jataganë fj. u. shih te JATAGAN,~I.
- MINARE** f. Nuk futet (nuk hyn, nuk fshihet) minarja (hosteni) në thes fj. u. nuk mund të fshihet një e vërtetë që duket sheshit.
- MINUTË** f. Ç'sjell minuta, s'e sjell ora (s'e sjell moti) fj. u. mund të ndodhë papritur një gjë e rëndësishme në një çast shumë të shkurtër.
- MIQËSI** f. Miqësia miqësi, puna punë. fj. u.

- MIRË** f. Ia diti për të mirë. As e mira, as e keqja (e liga) nuk duhen harruar. fj. u. E mira e ka të mirën fj. u. kush bën mirë, gjen mirë.
- MIRË** mb. Trimi i mirë me shokë shumë. fj. u. Kali i mirë njihet nën mutaf fj. u. shih te MUTAF,~I. Kroi (pusi) i mirë njihet në kohë të thatë fj. u. shih te KRUA, KROI. Kur s'ke grurë, e mirë është edhe thekra fj. u. shih te THEK/ËR,~RA.
- MIRË** ndajf. Më mirë shkelmi se helmi fj. u. shih te SHKELM,~I. Më mirë të të dalë syri sesa nami fj. u. shih te SY,~RI. Më mirë djepin thatë (bosh) se shejtanin brenda fj. u. shih te DJEP,~I. Më mirë të shkojë kryet (koka) se fytyra fj. u. shih te KRYE,~T.
- MIRËNI** f. Gjendje ekonomike e mirë; pasuri, kamje. Më mirë të kesh dituri se mirëni. fj. u.
- MIRËSI** f. Mirësia shpërblehet me mirësi. fj. u.
- MISH** m. S'ndahet mishi prej thoit fj. u. përdoret kur flasim për dy vetë që janë të lidhur ngushtë njëri me tjetrin. Shumë pupla e pak mish fj. u. shih te PUP/ËL,~LA. Dasmë pa mish nuk ka (nuk bëhet) fj. u. shih te DASMË,~A. Çdo mish (berr) varet nga këmbët e veta (në çengelin e vet) fj. u. Edhe mishi të piqet, edhe helli të mos digjet fj. u. ta bëjmë një punë pa dëmtuar tjetrën (thuhet kryesisht, kur përpiqemi ta ndihmojmë dikë).
- MIZË** f. Miza kur bën krahë, harron folenë ku e ka. fj. u. Shqiponja nuk ha miza fj. u. shih te SHQIPONJ/Ë,~A. Mjalti i tërheq mizat fj. u. shih te MJALT/Ë,~I. S'ngopet ariu me miza fj. u. shih tek ARI,~U. Po shtive mizën (milingonën), të iku hambari fj. u. shih te SHTIE.
- MJALTË** m. Mjalti i tërheq mizat fj. u. thuhet kur dikush i bën lajka e i sillet rrotull një njeriu të pasur a të pushtetshëm për të nxjerrë përfitime prej tij. Çdo mizë nuk bën mjaltë fj. u. shih te MIZ/Ë,~A. Këmbë për baltë, gojë për mjaltë fj. u. shih te BALT/Ë,~A. Lëpi mjaltin, po mos e ha gishtin! fj. u. fol e bëj shaka, po mos e tepro; ki kujdes, mos lakmo aq shumë, se e pëson.
- MJEGULL** f. Ujku mjegull do (kërkon). fj. u.
- MJEK** m. Ku hyn dielli nuk hyn mjeku. fj. u.
- MJEKËR** f. Vetëm mjekra e qoses nuk rregullohet. fj. u. Kush ka mjekër, mban edhe krehër. fj. u.
- MJERUAR** mb. 3. Përd. em. sipas kuptimit të mbiemrit (për njerëzit). I përtuari, i mjeruari. fj. u.
- MOKËR** f. Goja pa dhëmbë është mulli pa mokra. fj. u.
- MOLEPS** kal. Dhia e zgjebosur moleps gjithë kopenë. fj. u.
- MOLLË** f. Mollët i qëro, dardhët i numëro. fj. u. mollë ha sa të duash, se nuk të prishin, ndërsa dardhët haji nga pak, se janë të rënda për stomakun.
- MORR** m. zool. Hunda në lis, morri në kurriz fj. u. mendjemadhësia sjell gjithmonë të këqija, mendja e madhe e zeza e të zot.
- MOT** m. E kthen gëzofin si të jetë moti. fj. u. Hyri viti, shkoi moti. fj. u. Kush është i zoti, s'i shkon zi moti. fj. u. Ç'sjell sahati nuk sjell moti fj. u. shih te SAHAT,~I.
- MOT** ndajf. Më mirë një vezë sot se një pulë mot. fj. u.
- MOTËR** f. Motra jemi, shoqe s'jemi. fj. u. thuhet për dy motra që kanë veti e tipare të kundërta e që zakonisht nuk shkojnë mirë. Shpatullat me zemrën s'janë motra fj. u. shih te SHPATULL,~A.
- MOTUAR** mb. Detyra e motuar lahet në mot të shtrënguar. fj. u.
- MPIHEM** vetv. Kur s'ha kumbulla, s'të mpihen dhëmbët (dhëmballët) fj. u. pa bërë gjë s'ke pse të shqetësohesh, s'ke pse të kesh frikë (i thuhet zakonisht dikujt që ka bërë një faj a gabim, por shtiret sikur nuk është fajtor).

- MUHABET** m. bised. Kur zgjatet muhabeti, pakësohet bereqeti. fj. u. fjalët e shumta janë fukarallëk, fjalëshumë e punëpak.
- MULLAR** m. S'bën macja mullar fj. u. mos prit punë a përfundime të mira nga një njeri i pazoti, s'të zgjidh dot gjë një njeri i paaftë. Kur m'u dogjën mullarët, njoha miqtë e kumbarët fj. u. miku a shoku i vërtetë njihet kur jemi në gjendje të vështirë, kur na kanoset një rrezik.
- MULLI** m. Mulliri bluan me aq ujë sa ka fj. u. s'mund të bëhet diçka jashtë fuqive, jashtë mundësive etj., secili bën aq sa ka mundësi. Kush vete në mulli doemos do të përmiellet fj. u. s'mund të rrish pa marrë pjesë në punën, në jetën, në veprimtarinë, në shqetësimet etj. të mjedisit që të rrethon; në qoftë se pranon të bësh një punë, atëherë do të pranosh edhe pasojat e saj.
- MUND** II kal. Dy mace mundin një ari. fj. u. Trim është ai që mund veten. fj. u. trim është ai që mposht dobësitë e veta, veset etj.
- MUNDOHEM** vetv. S'u lodhe sot, do të mundohesh mot. fj. u. Kush mundohet t'i bëjë varrin tjetrit, bie vetë brenda. fj. u.
- MUNDUAR** mb. I veçuari, i munduari fj. u. kush ndahet nga shokët është i pa-fuqishëm e vuan, bashkimi bën fuqinë.
- MUNGESË** f. Mungesat miku-mikut ia duron. fj. u.
- MUNGOJ** jokal. Halla di të bëjë byrek, po i mungon mielli. fj. u. thuhet për dikë që është i zoti për një punë, po nuk ka mjetet e nevojshme.
- MUR** m. Burri në shkallë, po shkallë në mur fj. u. shih te SHKALL/Ë,~A. Gur gur bëhet mur fj. u. ca e nga ca mbarohet një punë e rëndësishme, pak e nga pak mund të arrish diçka të madhe. Një gur s'bën (s'çon) mur fj. u. shih te MUR, ~I. Muri luan, burri s'luan fj. u. ai që është burrë e mban fjalën. S'i bihet murit me kokë fj. u. s'duhet t'ia hysh një veprimi krejt të paarsyeshëm, është e kotë të nisësh diçka të pamundshme. Shkul një gur nga një mur (shkul një qime nga një derr) shih te SHKUL. Fusha ka sy e muri (pylli, gardhi, mali) ka veshë fj. u. shih te FUSH/Ë,~A.
- MURGJAN** m. Çdo murgjan ka një kalorës. fj. u.
- MURRIZ** m. bot. Gjithkujt murrizi i vet i duket i njomë fj. u. iron. thuhet kur dikush lavdëron tepër gjërat e veta, fëmi-jët e vet a punën e vet, edhe kur nuk e meritojnë.
- MUSTAQE** f. kryes. S'lind burri me mustaqe fj. u. nuk bëhet çdo gjë menjëherë, asgjë nuk vjen e gatshme; duhet mund e përpjekje për të bërë një punë të vështirë.
- MUSHKË** f. Mushkës xanxare ia vënë drutë më të trasha (barrën më të rëndë). fj. u. atë që grindet a që hedh shkëlma e ngarkojnë me punë më të rënda që të shtrohet. Nuk mbarset mushka të pjellë mëz fj. u. nuk mund të bëhet a të ndodhë diçka e pamundshme, jashtë mendjes, edhe pse e mendon dikush. S'trembet ujku nga mushkonjat fj. u. shih tek UJK,~U.
- MUSHT** m. Gushti me rrushin, vjeshta me mushtin. fj. u.
- MUSHTËKOHEM** vetv. Fëmija mushtëkohet pas nënës si ylli pas hënës. fj. u.
- MUTAF** m. Kali i mirë njihet nën mutaf fj. u. njeriu njihet në punë e sipër, njeriu duhet çmuar nga puna që bën.
- MYKË** f. Myka e di sa e fortë është gozhda fj. u. ai që e bën punën e di se ç'vështirësi ka ajo.
- NAFAKË** f. bised. Ditë e re, nafakë e re. fj. u.
- NAM** m. bised. Më mirë të të dalë syri sesa nami fj. u. shih te SY,~RI.
- NATË** f. Nata është me barrë fj. u. nata ka të papritura, nuk dihet se ç'ndodh. Dita ka sy e nata ka veshë fj. u. shih te VESH,~I.

- NDAHEM** vetv. Delja që ndahet nga shoqet e ha ujku. fj. u.
- NDER** m. Po të duash nder, sillu me nder. fj. u.
- NDEZJE** f. Ndezja e zjarrit nuk fillon nga trangu fj. u. shih te TRUNG,~U.
- NDJELL** kal. Ç'ndjell, mbështjell. fj. u.
- NDOT** kal. Kush ndot këmbët luan dhëmbët fj. u. kush punon ha.
- NDREQEM** vetv. Druri ndreqet sa (kur) është i njomë fj. u. njeriu edukohet më lehtë kur është në moshë të re.
- NDRIT** jokal. Çdo gjë që ndrit nuk është ar (flori). fj. u.
- NDYJ** kal. Shkopin, po e ndyve të tërë, s'ke ku e kap fj. u.
- NESËR** ndajf. Punën e sotme mos e lërë për nesër. fj. u.
- NEVOJË** f. Miku njihet në nevojë. fj. u.
- NËNË** f. Fëmija pa nënë, si nata pa hënë fj. u. Përsëritja është nëna e të mësuarit. libr. fj. u. Po nuk qau fëmija, nuk i jep nëna (e ëma) sisë (gji) të pijë fj. u. shih te QAJ.
- NGEC** jokal. Thela e madhe të ngec në fyt fj. u. shih te THEL/Ë,~A.
- NGOPUR** mb. 4. Përd. em. sipas kuptimit 1 të mbiemrit. I ngopuri se kupton të uriturin. fj. u.
- NGRIHEM** I vetv. Kush fle me qenin (me qentë) ngrihet me pleshta fj. u. shih te QEN,~I.
- NGROH** kal. Dielli ngroh (lind) për të gjithë fj. u. shih te DIELL~I. Flaka të djeg, prushi të ngroh fj. u. shih te PRUSH,~I.
- NGJITEM** I vetv. Në çati ngjiten me shkallë fj. u. shih te SHKALL/Ë,~A. Buka që thyhet, s'ngjitet me fj. u. shih te BUK/Ë,~A. Po u thye kulaçi, s'ngjitet më fj. u. shih te KULAÇ,~I.
- NUMËROJ** kal. Thanat nuk numërohen fj. u. shih te THAN/Ë,~A.
- NXË** I kal. Një mill s'i nxë dy jataganë fj. u. shih te JATAGAN,~I.
- NXITTOJ** kal. Kush nxiton gabon. fj. u.
- NXJERR** kal. Ç'ka barku e nxjerr bardhaku fj. u. shih te BARDHAK,~U. Korbi korbit (sorra sorrës) s'ia nxjerr sytë fj. u. shih te KORB,~I. I zoti e nxjerr (e qit) gomarin nga balta fj. u. shih te BALT/Ë,~A. Një thumb, njëqind herë të rrahësh, një majë nxjerr fj. u. shih te THUMB ~I. Shqiptarin nuk e ka nxjerrë lokja prej barkut, por huta prej çarkut fj. u. shih te HUT/E, ~A II.
- NJERI** m. Njeriu për njeriun është. fj. u. Njeriu, sa rron, mëson, fj. u. Mali me mal s'piqen, njeriu me njeriun piqen. fj. u.
- NJERK** m. Njerku s'është baba. fj. u.
- NJË** Pa thënë një, nuk thonë dy. fj. u. Një si asnjë fj. u. diçka e vetme është e pamjaftueshme, nuk kryen punë. Mat shtatë (tri, dhjetë) herë e pre një herë! fj. u. shih te MAT.
- NJËRI** pakuf. Njëra dorë lan tjetrën, të dyja lajnë fytyrën. fj. u. bised.
- NJIHEM** vetv. Hekuri njihet në zjarr, miku në nevojë. fj. u. Kroi i mirë njihet në kohë të thatë. fj. u.
- NJOH** kal. Kur m'u dogjiën mullarët, njoha miqtë e kumbarët. fj. u.
Vampiri e njeh lugatin fj. u. shih te VAMPIR,~I. Nuk e njeh (nuk e merr vesh) i pari të dytin shih te PARË (i,e). S'e njeh qeni të zotin shih te QEN,~I.
- NJOMË** mb. Druri ndreqet sa (kur) është i njomë fj. u. shih te DRU,~RI. Gjithkujt murrizi i vet i duket i njomë fj. u. shih te MURRIZ,~I. S'ka ç'i bën shkëndija eshkës së njomë (së lagur) fj. u. shih te SHKËNDIJ/Ë,~A.
- OBORR** m. Mos i shiko shkallët, por shikoji oborrin dikujt! fj. u. shih te SHKALL/Ë,~A.

- OKË** f. Okën piqe, pikën mos e derdh! fj. u. mos e kurse gjënë për shëndetin, por kot mos e humb!
- OREKS** m. Oreksi vjen duke ngrënë. fj. u.
- ORË** I f. Ç'sjell (ç'bie) ora, s'e sjell (s'e bie) moti (viti). fj. u. Ç'sjell minuta s'e sjell ora (s'e sjell moti). fj. u.
- ORIZ** m. bot. S'ka oriz pa gurë fj. u. shih te GUR,~I.
- ORTAK** m. Ortakë jemi, shokë s'jemi. fj. u.
- OXHAK** m. Tymi të shkojë drejt, pa le të jetë oxhaku i shtrembër! fj. u. shih tek TYM,~I.
- PA** II parafj. Fëmija pa nënë si nata pa hënë. fj. u.
- PA** III lidh. bised. Qoftë kryet shëndoshë, pa kësula gjen sa të duash. fj. u.
- PAFTUAR** mb. Kush shkon i pa ftuar, e gjen të pashtuar. fj. u.
- PAGUAJ** kal. Pagan një grosh e hyn në valle, pagan njëqind e s'del dot fj. u. është lehtë t'i hysh një pune, por është shumë e vështirë t'ia dalësh mbanë.
- PAGUHEM** vetv. 3. Pës. e PAGUAJ. Nderi nuk paguhet me para. fj. u.
- PAK** I pakuf. Më mirë pak e sak, se shumë e për lumë. fj. u. Fjalë pak e punë shumë. fj. u.
- PALCË** f. Mos i shiko lëvozhgën, po shikoj palcën! fj. u.
- PALLË** f. Nuk hyn palla në thes. fj. u.
- PAPUNËSI** f. Papunësia është nëna e të gjitha të ligave. fj. u.
- PARA** f. Nderi nuk blihet me para. fj. u. Njeriu bën paranë, jo paraja njeriun. fj. u.
- PARË** m. Kë keni të parë këtu! Ku ka shumë të parë, puna s'ecën mbarë. fj. u.
- PASHTRUAR** mb. Kush vjen (kush shkon) paftuar, e gjen të pashtuar. fj. u.
- PATË** f. zool. Pula e fqinjës (e tjetrit) të duket patë fj. u. gjëja e tjetrit të duket më e mirë a më e madhe se jotja, pula e botës të duket më e majme.
- PAZANAT** mb. I pazanat - i pafat. fj. u.
- PAZAR** m. bised. Me tëndin ha e pi e pazar mos bëj. fj. u. Nuk humbi (s'u shua) pazari për gjilpëra fj. u. shih te HUMB. Hesapi i shtëpisë nuk del në pazar fj. u. shih te HESAP,~I.
- PAZOTI** mb. 2. Përd. em. sipas kuptimit të mbiemrit. I pazoti dhe mbi trëndafila të bjerë thyen hundët. fj. u.
- PE** m. Peri këputet ku është më i hollë. fj. u. ndodh diçka atje ku s'duhej të ndodhte, ku bëhet dëmi më i madh, ku gjendja është më e dobët etj. Ku futet gjilpëra, do të futet edhe peri fj. u. ku është (ku shkon) njëri, do të jetë (do të shkojë) patjetër edhe tjetri. Nga peri mund të kapet edhe lëmshi fj. u. nga një e dhënë e vogël, nga një burim i vogël mund të zbulohet a të sqarohet gjithë çështja. Për një pe, për një gjilpërë, shkoi dëm një gunë e tërë fj. u. për pak punë, për pak mundim ose për diçka fare të vogël, shkoi dëm një gjë e madhe.
- PELË** f. Çon një pelë e ha një thelë fj. u. harxhon shumë dhe fiton pak; i kushton shumë shtrenjtë diçka.
- PEMË** f. Njeriu që vetëm për vete punon, është si dru që pemë s'lëshon. fj. u. Pema pa u pjekur s'hahet fj. u. çdo gjë do kohën e vet, do kushtet e nevojshme që të bëhet a të zhvillohet. E drejta i ka pemët te dera fj. u. shih te DREJT/Ë,~A (e) 6. Pema e kalbur kalb (kalbëzon) edhe shoqet fj. u. një njeri i keq mund të prishë edhe të tjerët. Sheh pema pemën e piqet fj. u. dikush sillet e vepron njëlloj si tjetri, sipas njerit bën edhe tjetri, sheh rrushi rrushin e piqet. Kur dëgjon se ka shumë pemë, merr shportën e vogël fj. u. kur të premtojnë shumë, të japin pak; kur merr shumë premtime, ato nuk plotësohen të gjitha. Pemën, kur s'pjell, e presin se i bën hije

- dardhës fj. u. njeriu i dëmshëm duhet hequr qafe se prish të tjerët.
- PENDAR** m. Pendar i ruan vreshtat fj. u. thuhet për të theksuar se dikush nuk i shkel rregullat jo sepse është i ndërgjegjshëm, po sepse ka frikë se mos e shohin a mos e kontrollojnë, frika i ruan vreshtat.
- PENDOHEM** vetv. S'mendove (s'punove) sot, do të pendohesh mot. fj. u.
- PENGOHEM** vetv. U pengua era. fj. u.
- PESHË** f. Besa e burrit, pesha e gurit fj. u. shih te BES/Ë,~A. Fjala e burrit, pesha e gurit fj. u. burri kur e jep fjalën nuk e luan.
- PESHK** m. Peshku në det e tigani në zjarr fj. u. iron. thuhet kur një punë ende s'është kryer, kurse dikush kërkon para kohe të gëzojë të mirat që do të vijnë prej saj pasi të përfundojë; është tepër herët për diçka. Peshku i madh e ha të voglin fj. u. ai që është më i fuqishëm e zhduk më të voglin ose më të dobëtin, fiton më i forti edhe kur e drejta është në anën e më të dobëtit ose e më të voglit (karakteristikë për shoqërinë me klasa shfrytëzuese dhe për moralin borgjez).
- PETANIK** m. Si është miku, bëhet petaniku fj. u.
- PETULL** f. Nuk bëhen ato petulla që t'i jep (t'i sjell) shigjetulla fj. u. janë të rrezikshme dhuratat që vijnë nga armiku.
- PËLCAS** jokal. Kush ha djathë nga të hoxhës, pëlçet për ujë. fj. u. shih te HOXH/Ë,~A.
- PËLLËMBË** f. S'matet deri me pëllëmbë fj. u. për të kryer punë të mëdha duhen mjetet e nevojshme.
- PËQI** m. Prish (gris) gjirin, arno pëqirin fj. u. shih te GRIS.
- PËRGJYSMOHEM** vetv. Kur je me shok, përgjysmohet hidhërimi e dyfishohet gëzimi. fj. u.
- PËRJASHTIM** m. Përrjashtimi forcon rregullën. fj. u. libr.
- PËRMIELLEM** vetv. Kush vete në mulli (doemos) do të përmiellet. fj. u.
- PËRMUTEM** vetv. Kush ngutet, përmutet. fj. u. thjeshtligj. kush nxiton e prish punën krejt; kush nxiton pa nevojë, thyen qafën.
- PËRNGJAJ** jokal. përf. Bëmë baba, le të përngjaj (të të ngjaj). fj. u. thuhet kur fëmija ngjan shumë me prindin në sjellje e në mendime.
- PËRPARA** Qentë le të lehin, karvani shkon përpara fj. u. shih te LEH.
- PËRPJETË** f. Ka të përpjeta, (po) ka edhe të tatëpjeta fj. u. shih tek TATËPJET/Ë,~A(e) 2.
- PËRPJETË** Mos shiko (vështro) gjithnjë përpjetë, po shiko (vështro) edhe tatëpjetë fj. u. shih tek TATËPJETË.
- PËRQESH** kal. Kush përqesh, e qeshin. fj. u.
- PËRQESHUR** m. I zhveshuri, i përqeshuri. fj. u.
- PËRSHESH** m. Lopa në mal, përsheshi në vatër (në xham) fj. u. shih te LOP/Ë,~A.
- PËRTACI** f. Përtacia sjell varfërinë. fj. u.
- PËRZIHIM** I vetv. Mos u përziej me krundet, se do të të hanë pulat! (Po të përzihesh me krundet, të hanë pulat.) fj. u. shih te KRUNDE,~T.
- PËRROSKË** f. Përrua i vogël; rrëke uji; përrua që zakonisht thahet në verë; përrua i tharë ose lug që formohet nga shirat në rrëpirën e një kodre a të një mali. Përrorskë e thatë. Përroska, përroska bëhet lumi. fj. u.
- PËSOJ** kal. Koka bën, koka pëson. fj. u. Kush e bën, kush e pëson!
- PËSUAR** mb. 2. Përd. em. sipas kuptimit të mbiemrit. I pësuar, i mësuar. fj. u.
- PËSHTYJ** kal. Ku pështyjnë shumë, bëhet një lumë. fj. u.

- PËSHTYMË** f. S'mbushet pusi me pështymë (me gjilpëra) fj. u. thuhet për një punë që nuk ka mundësi të bëhet (në kuptimin «duhen mjetet e nevojshme për të bërë diçka të rëndësishme, nuk thahet deti me lugë»).
- PI** kal. Po nuk qau fëmija, nuk i jep nëna (e ëma) sisë (gji, të pijë) fj. u. shih te QAJ.
- PIKA-PIKA** ndajf.
Pika-pika (pikë-pikë) bëhet lumi (zgavrohët guri) fj. u. duke punuar me ngulm e vazhdimisht nga një çikë mund të bëhen punë të mëdha e të rëndësishme; gurë, gurë bëhet kalaja.
- PIKË** f. Pika (cirka) shpon gurin fj. u. duke punuar e duke u përpjekur pandërprerë mund të kapërcehen vështirësi të mëdha e të bëhen punë të rëndësishme. Okën piqe, pikën mos e derdh fj. u. shih tek OK/Ë,~A.
- PIKË-PIKË** ndajf.
Pikë-pikë (pika-pika) bëhet lumi (zgavrohët guri) fj. u. shih te PIKA-PIKA.
- PIKOJ** kal. I zoti e di ku i pikon çatia (shtëpia) fj. u. shih te ZOTI (i).
- PIQEM** I vetv Nuk piqet buka me shkarpa fj. u. shih te SHKARP/Ë,~A. Sheh rrushi rrushin (fiku fikun) e piqet fj. u. shih te RRUSH,~I. Edhe mishi të piqet, edhe helli të mos digjet fj. u. shih te MISH,~I.
- PIQEM** II vetv. bised. Mali me malin nuk piqet, njeriu me njeriun piqet. fj. u.
- PIRUN** m. Luga mbush barkun, piruni than gurmazin fj. u. shih te LUG/Ë,~A.
- PJEK** I kal. Pema pa u pjekur s'hahet. fj. u.
- PJELL** kal. dhe jokal. Nuk mbarset mushka të pjellë mëz fj. u. shih te MUSHK/Ë,~A. U mbars mali e polli një mi fj. u. shih te MAL,~I. Ç'pjell macja (ç'len prej maces), gjuan minj fj. u. keq. shih te MAC/E, ~JA.
- PLAF** m. Shtriji (zgjati) këmbët sa ke plafin (jorganin, shtratin) fj. u. shih te JORGAN,~I.
- PLAGË** f. Plaga shërohet, po fjala e hidhur s'harrohet. fj. u.
- PLAK** m. Mos u bëj plak në shtëpinë e botës! fj. u. mos ndërhy në punët e të tjerëve. Hem të vë plak, hem të rruan mjekrën. fj. u. edhe të ngarkon vetë për një punë, edhe nuk të dëgjon, nuk të pyet ose nuk të përfill fare.
- PLEH** m. Kush shkon pas brumbullit, te plehu do ta shpjerë fj. u. shih te BRUMBULL,~I.
- PLEQËRI** f. Nuk punove në të ri, rri e qaj në pleqëri. fj. u.
S'mëson kali revan në pleqëri fj. u. shih te REVAN,~I.
- PLESHT** m. S'del dhjamë nga pleshti fj. u. përçm. shih te DHJAM/Ë,~I. Ia futi (ia shtiu) pleshtat në vesh dikujt e ngacmoi për diçka, e bëri që të shqetësohej, i shtiu mizat. S'futen pleshtat në thes (s'mblidhen pleshtat në grusht) fj. u. është punë që s'bëhet, është e pamundur të bëhet diçka.
Kush fle me qenin (me qentë), ngrihet me pleshta fj. u. shih te QEN,~I.
- PLIS** I m. Nuk rri iriqi në plis fj. u. njeriu dëshiron të jetë gjithnjë i lirë, nuk i pëlqen zogut kafazi. Nuk zihet (nuk mbulohej) dielli me plisa fj. u. shih te DIELL,~I.
- PLOT** ndajf. Urtë e butë e plot tiganin fj. u. shih tek URTË.
- PLOTË** mb. Kalliri i plotë e mban kryet ulur. fj. u.
- PLUG** m. Plugu i janarit është vlagë e beharit. fj. u. Sasi dheu aq sa ngre kjo vegël në një hulli.
Derri do plumb. fj. u. I rëntë plumbi! mallk.
- PO** I lidh. Po s'luajte këmbët, s'luan (as) dhëmbët. fj. u. Po s'hëngre hudhra, s'bie erë. fj. u.
- POÇE** f. E di luga se ç'ka poçja (vegshi, vorba) fj. u. shih te LUG/Ë,~A.

- POR** lidh. Erdhi, por pak vonë. Liria nuk dhurohet, por fitohet me gjak. fj. u.
- PORDHË** f. Nuk i dëgjon njeri pordhët e tij. S'mbahet shtëpia me pordhë. fj. u. Nuk skuqen vezët me pordhë. fj. u.
- POTKUA** m. Për një gozhdë (për një thumb) shkoi (humbi) potkoi fj. u. shih te GOZHD/Ë,~A. Kur t'i hipësh kalit, shihi potkonjtë fj. u. përgatitu e sigurohu mirë para se të nisësh një punë.
- PRANVERË** f. Me një lule (me një dalëndyshe) s'vjen pranvera (behari) fj. u. shih te LUL/E~JA.
- PRAPA** Uji që rrjedh, nuk kthehet prapa. fj. u. Dardha e ka bishtin prapa fj. u. shih te DARDH/Ë,~A.
- PRASHITJE** f. Dy prashitje janë sa një ujitje. fj. u.
- PREHËR** m. I vogël për prehër, i madh për zemër fj. u. i vogël në moshë, por trim.
- PREK** kal. E bardhë është edhe bora në mal, por po ta prekësh mërdhin. fj. u. jo çdo gjë që është e bukur a e ndritshme, është doemos edhe e mirë; pamja të gënjen. Mos i prekni pemët! Ku s'ke vënë mos prek! fj. u. Mos më prek! Qan pa prekur. S'e preku askush. Mos e prek macen, se të gërvisht! Mos e prek gjarprin në bisht, se të ha në gisht! fj. u.
- PRES** I kal. Gjuha pret hekurin (çan gurin, çan shkëmbin) fj. u. shih te GJUH/Ë,~A I. Mat tri (shtatë, dhjetë) herë e pre një herë! fj. u. shih te MAT.
- PRESH** m. bot. Humbi në vaj e fitoi në presh fj. u. shih te VAJ,~I I.
- PRESHTË** mb. Kalë të preshtë nuk ka fj. u. një gjë e tillë as që mund të jetë, është diçka e pamundur.
- PRILL** m. Prilli bën lulen e maji ka nderin. fj. u. thuhet kur dikush e bën një punë por frytet ia rrëmben një tjetër.
- PRISH** kal. Pesha e borës e prishi çatinë. Po nuk prishe, nuk ndërton. fj. u. Prish bucela e bëj kënaçe. fj. u. Prish shtëpi e bën kasolle. fj. u. prish diçka të madhe e me vlerë për diçka të vogël e me vlerë te paktë. Mos e prish kazanin (jahninë) për një qepë! fj. u. mos e dëmto diçka të madhe për një gjë fare të vogël.
- Fiton pesë prish (ha) gjashtë. fj. u. Kush merr shtatë e prish tetë, s'ka nevojë për kuletë. fj. u. Nuk e prishim plumbin kot.
- Prish (gris) gjirin, arno pëqirin! fj. u. shih te GRIS. Uthulla e fortë prish enën e vet fj. u. shih tek UTHULL,~A. Një dru i shtrembër prish (rrëzon) gjithë stavën fj. u. shih te STAV/Ë,~A.
- PRISHEM** vetv. S'prishet dasma për një qepë (për një limon) fj. u. shih te DASM/Ë,~A.
- PRITEM** I vetv. S'pritet lisi (druri) me një shpatë (me një të rënë të sëpatës) fj. u. shih te SËPAT/Ë,~A.
- PROÇKË** f. keq. Pasi bëri proçkën, rri e kruan kokën. fj. u.
- PROVOJ** kal. Arin e provojnë në zjarr. fj. u.
- PRUSH** m. Flaka të djeg, prushi të ngroh fj. u. duhet të mbështetesh te diçka që është e qëndrueshme dhe jo te diçka që kalon shpejt. Kusia mbi prush, thëllëza në fushë fj. u. shih te KUSI,~A.
- PULË** f. Kur s'ke pula, mos bëj «ish»! fj. u. thuhet kur e këshillojnë dikë të mos përzihet në punët që s'i takojnë. Më mirë një vezë sot, se një pulë mot fj. u. shih te VEZ/Ë,~A. Pula e botës duket më e madhe fj. u. iron. thuhet kur ajo që nuk të përket ty ose ajo që nuk e njeh të duket më e mirë. Atë që ul qafën, e dhjesin pulat fj. u. thjeshtligj. atë që gjunjëzohet ose nënshtrohet e marrin të gjithë nëpër këmbë. Mos u përziej me krundet, se do të të hanë pulat! (po të përziehesh me krundet, të hanë pulat) fj. u. shih te KRUNDE,~T.
- PUNË** f. Puna e njeh njeriun. fj. u. Puna çan malet. fj. u. Pa punë s'ka gunë. fj. u. E ka punën në gjak. Fjalë pak e punë shumë. Punë, punë natë e ditë që

- të shohim pakëz dritë. fj. u. Nga secili sipas aftësive, secilit sipas punës. Punën e sotme mos e lër për nesër. fj. u. Ku ke punën, shtro (edhe) gunën. fj. u. I erdhi gjithë puna.
- PUNËLUMË** mb. 2. Përd. em. sipas kuptimit të mbiemrit. Fjalëshumi - punëlumi. fj. u.
- PUNËMBARUAR** mb. 2. Përd. em. sipas kuptimit të mbiemrit. Fjalështruari - punëmbaruari. fj. u.
- PUNËSHTRUAR** mb. 2. Përd. em. sipas kuptimit të mbiemrit. Punështruari - i uruari (i lëvduari). fj. u.
- PUNËTHATË** mb. 2. Përd. em. sipas kuptimit të mbiemrit. Fjalëgjati - punëthati. fj. u.
- PUNOJ** jokal. Kush punon, gëzon. fj. u. Kush s'punon, dheut i rëndon. fj. u. Kush nuk punon, nuk ha. fj. u. Punove - gëzove. fj. u.
- PUPËL** f. Shumë pupla e pak mish fj. u. thuhet për dikë që nga pamja e jashtme duket sikur diç është, por në të vërtetë nuk ka ndonjë vlerë të madhe ose është fyçkë nga mendja; fjalëshumë e punëpakë.
- PURTEKË** f. Besa e shqiptarit si purteka e arit. fj. u.
- PUS** m. S'bëhet pusi me gjilpëra fj. u. shih te GJILPËR/Ë,~A. S'mbushet pusi me pështymë (me gjilpëra) fj. u. shih te PËSHTYM/Ë,~A. Mos hyr në pus me litarin e botës! fj. u. mbështetu në forcat e tua!, mos shpreso shumë në ndihmat e të tjerëve! Pusi (kroi) i mirë njihet në kohë të thatë fj. u. shih te KRUA, KROI.
- PUSI** f. Pusia të ha. fj. u.
- PYES** kal. Kush pyet, s'humbet (s'tret). fj. u. Humbi kokën e pyet për flokët fj. u. shih te HUMB. Po s'pate shokun, pyet shkopin! fj. u. është mirë që për çdo gjë të këshillohesh më parë me dikë a të marrësh mendimin e dikujt. Pyet njëqind (shtatë a tetë) vetë, e bëj si di vetë! fj. u. këshillohu me të tjerët, merr mendimin e të tjerëve dhe më në fund vendos vetë për diçka.
- PYKË** f. Pyka shtyhet (nxirret) me pykë [pykën e shtyn (e nxjerr) pyka] fj. u. thuhet kur dikush duhet kundërshtuar, luftuar a zhdukur me të njëjtat mjete që ka përdorur edhe ai vetë. Shkojnë mykë e pykë shih te MYK/Ë,~A.
- PYLL** m. Nuk ka pyll pa derra fj. u. shih te DERR, ~ I. Fusha ka sy e pylli (mali, gardhi, muri) ka veshë fj. u. shih te FUSH/Ë, ~A.
- QAFË** f. Atë që ul qafën, e dhjesin pulat fj. u. thjeshtligj. shih te PUL/Ë, ~A. Mendja e madhe ta thyen qafën (zverkun) fj. u. shih te MENDJ/E,~A. Nga lëviz qafa, kthehet koka fj. u. nga diçka më e vogël e më pak e rëndësishme varet diçka kryesore.
- QAJ** jokal. I fundit o qesh o qan. fj. u. ai që mbetet në fund kur ndahet diçka në pjesë o fiton o humbet (sepse mund t'i mbetet një pjesë më e madhe, por mund t'i mbetet edhe një pjesë më e vogël).
- QEFJ** m. bised. Qejfi qejf, puna punë. fj. u.
- QEN** m. Qenit tregoji shkopin. fj. u. Qenit u bëj qen fj. u. Qeni leh atje ku ha fj. u. keq. thuhet kur dikush mban pa të drejtë anën e atij, nga i cili ka përfitime. Kujto (zër në gojë) qenin, rrëmbe (bëj gati) shkopin fj. u. thuhet kur dikush vjen sapo ia kemi përmendur emrin. Qeni që leh nuk të ha (nuk të kafshon); fj. u. shih te LEH. Kush fle me qenin (me qentë), ngrihet me pleshta fj. u. po të shoqërohesh me njerëz të këqij, do të marrësh veset e tyre; më thuaj me kë rri, të të them se cili je. Qentë le të lehin, karvani shkon përpara fj. u. shih te LEH.
- QEPË** f. bot. S'prishet dasma për një qepë (për një limon) fj. u. shih te DASM/Ë,~A.
- QEROS** m. Te koka e qerosit të gjithë bëhen berberë fj. u. thuhet kur një punë është

- fare e lehtë e mund ta bëjë kushdo pa asnjë vështirësi.
- QESH** jokal. I fundit o qesh o qan fj. u. shih te QAJ.
- QETHUR** mb. Shkoi (vajti) për lesh e doli (u kthye, erdhi) i qethur fj. u. iron. shih te LESH,~I.
- QË** Ai që punon, ha. fj. u.
- QËNDROJ** jokal. S'qëndron breshri mbi breshkë fj. u. shih te BRESH/ËR,~RI.
- QIELL** m. S'kapet qielli me dorë fj. u. është e pamundur.
- QILAR** m. Është më afër dera se qilari fj. u. shih te DER/Ë, ~A. I flas derës të dëgjojë qilari shih te FLAS.
- QIME** f. Ujku qimen e ndërro, po lëkurën s'e ndërro (po zakonin s'e harron). fj. u.
- QIT** kal. I zoti e qit (e nxjerr) gomarin nga balta fj. u. shih te BALT/Ë,~A.
- QORR** mb. bised. Ku mblidhen shumë mami, lind fëmija qorr. fj. u.
- QULL** m. U dogj nga qulli (nga kungulli), e i fryn edhe kosit fj. u. e ka pësuar keq nga diçka e mëparshme dhe tregon kujdes të tepruar edhe kur nuk është e nevojshme.
- RE** I f. Nuk bie reja (rrufeja) në hithra fj. u. mospërf. shih te HITH/ËR,~RA.
- RE** I f. I bërtet së bijës ta dëgjojë e reja fj. u. e hedh fjalën për ta dëgjuar dikush tjetër, e thotë tërthorazi diçka, i bie pragut të dëgjojë dera.
- REVAN** m. S'mëson kali revan në pleqëri fj. u. thuhet për diçka që i ka kaluar koha dhe nuk mund të bëhet më.
- RËNDË** mb. Guri është i rëndë në vend të vet. fj. u.
- RËNË** f. S'pritet lisi (druri) me një të rënë të sëpatës (me një sëpatë). fj. u. shih te SËPAT/Ë,~A.
- RËNKOHEM** vetv. bised. Mikut iu rënko, armikut iu lëvdo! fj. u.
- RI** mb. Miq të rinj zër sa të duash po të vjetrit mos i harro. fj. u.
- RIGON** m. bot. Rigoni s'bëhet lis fj. u. thuhej nga klasat shfrytëzuese për të mohuar aftësitë dhe mundësitë e zhvillimit e të përparimit të njerëzve të thjeshtë.
- RINI** f. Kush punon në rini gëzon në pleqëri. fj. u.
- RUAJ** kal. Frika i ruan vreshtat. fj. u.
Ruaje (mbaje) zogun sa e ke në dorë! fj. u. shih te
- RUP** m. vjet. Nuk shkohet me tre rupe në dasmë fj. u. duhet të jesh i përgatitur mirë kur ndërmerr diçka të madhe.
- RRAH** kal. Hekuri do rrahur sa është në zjarr (sa është i nxehtë) fj. u. shih te HEKUR,~I. Një thumb, njëqind herë ta rrahësh, një majë nxjerr fj. u. shih te THUMB,~I.
- RRENË** f. bised. Rrena i ka këmbët të shkurtra. fj. u.
- RREZIK** m. Miku njihet në rrezik. fj. u. Mendja e madhe - rreziku i vetes. fj. u.
- RRËFEJ** kal. Puna e rrëfen njeriun. fj. u.
- RRËMBEJ** kal. Kujto (zër në gojë) qenin, rrëmbe (bëj gati) shkopin fj. u. shih te QEN,~I.
- RRËNJË** I f. E mësoi me rrënjë. Liria i ka rrënjët në gjak. fj. u. Nuk ka degë pa rrënjë fj. u. askush a asgjë nuk mund të ecë përpara pa pasur një themel të shëndoshë; nuk ka zhvillim pa mbështetje të shëndoshë; nuk ka majë pa rrëzë. Gjuha e ka rrënjën në zemër fj. u. shih te GJUH/Ë,~A. Mos mburr degët pa parë rrënjët! fj. u. për të vlerësuar diçka mos u mbështet në anët e jashtme, por shiko brendinë, thelbin, themelet, shkaqet, qëllimet.
- RRËZË** I f. Nuk ka majë pa rrëzë fj. u. askush a asgjë nuk mund të ecë përpara pa pasur një themel të shëndoshë; nuk ka zhvillim pa një mbështetje të shëndoshë.

- RRËZOJ** kal. Një dru e shtrembër rrëzon (prish) gjithë stavën fj. u. shih te STAV/Ë,~A.
- RRI** jokal. Thuamë me kë rri, të të them se cili je! fj. u. Ujë të rri, qelbet. fj. u. Nuk rri iriqi në plis fj. u. shih te PLIS,~I I. Kur rri (kur fle) koka, lëviz gjuha fj. u. shih te KOK/Ë, ~A. Ngrihu prift të rrijë (të ulet) hoxha! shih te PRIFT, ~I I. Të rrimë shtrembër e të flasim drejt! fj. u. shih te SH TREMBËR. Thesi bosh (i zbratur, pa gjë) s' rri (s' qëndron) më këmbë fj. u. shih te THES,~I.
- RRIHEM** vetv. . Hekuri rrihet sa është i nxehtë. fj. u.
- RROJ** jokal. Sa të rrosh do të mësosh. fj. u.
- RRUFE** f. Nuk bie rrufeja (reja) në hithra fj. u. mospërf. shih te HITH/ËR,~RA.
- RRUGË** f. Rruga vade s'ka fj. u. vjet. nuk i dihet se s' mund të ndodhë.
- RRUMBULLAKËT** mb. Bota është e rrumbullakët fj. u. i thuhet dikujt për t'i treguar se përsëri mund të takohemi me të për një çështje ose se gjendja mund të kthehet në të kundërtën.
- RRUNGAJË** f. Nuk sjell lumi gjithnjë rrungaja. fj. u.
- RRUSH** m. bëhet rrushi deng (s'bëhet deng me rrush) fj. u. është gjë që s'bëhet, është e pamundur. Kur s'ke rrush, ha edhe larushk fj. u. shih te LARUSHK,~U. Sheh rrushi rrushin (fiku fikun) e piqet fj. u. Marrin shembull njëri nga tjetri, veprojnë siç bëjnë të tjerët.
- SAHAT** m. bised. 'sjell sahati nuk sjell moti fj. u. në një çast mund të ndodhë diçka shumë e rëndë; e keqja mund të bëhet në çast.
- SAMAR** m. S'ka ç'i bën gomarit e i bie samarit fj. u. nuk arrin ose nuk guxon të dënojë fajtorin e vërtetë dhe i shkarkohet dikujt tjetër; e nxjerr zemërimin në kurriz të dikujt që nuk ka faj, e shfren dufin aty ku mundet, pa dënuar fajtorin e vërtetë.
- SE** Më mirë vonë se kurrë. fj. u. Më mirë të dish se të kesh. fj. u.
- SËPATË** f. S'pritet lisi (druri) me një sëpatë (me një të rënë të sëpatës) fj. u. punët e vështira kërkojnë përpjekje e durim.
- SISË** f. Po nuk qau fëmija, nuk i jep nëna (e ëma) sisë (gji, të pijë) fj. u. shih te QAJ.
- SITË** f. Shosha shosh, sita sit fj. u. shih te SHOSH/Ë,~A. E vunë në sitë e në shoshë dikë e vunë në lojë, e tallën, e përqeshën.
- SJELL** I kal. Nuk hahen ato petulla që t'i sjell (t'i jep) shigjetulla fj. u. shih te PETULL,~A. Ç'sjell minuta, s'e sjell ora (s'e sjell moti) fj. u. shih te MINUT/Ë,~A.
- SJELLJE** f. Sjellja e zbukuron njeriun. fj. u.
- SOFËR** f. Sofrën shtroje edhe me bukë e kripë (e qepë)! fj. u. mikun prite me atë që të kesh!
- SOSEM** vetv. bised. Nuk soset (nuk thahet) deti me lugë fj. u. shih te DET,~I.
- SOT** ndajf. Më mirë një vezë sot se një pulë mot fj. u. shih te VEZ/Ë,~A.
- STAN** m. S'bëhet stan me lepuj fj. u. nuk bëhet gjë me njerëz të paaftë a të papërshtatshëm, që nuk ngulen në një vend e nuk duan të punojnë në mënyrë të organizuar.
- STAVË** f. Një dru e shtrembër rrëzon (prish) gjithë stavën fj. u. një njeri me sjellje të keqe dëmton një kolektiv të tërë.
- STELË** I f. Qeni leh atje ku ka stelën. fj. u.
- STUHI** f. Kush mbjell erën do të korrë stuhinë (furtunën) fj. u. libr. shih te MBJELL.
- SY** m. Korbi korbit (sorra sorrës) s'ia nxjerr sytë fj. u. shih te KORB,~I. Larg sysh, larg zemrës fj. u. njeriun që është shumë kohë larg edhe mund ta harrojnë e të mos e kujtojnë si të afërt e të dashur. Më mirë të të dalë syri sesa nami fj. u. emri i mirë a i keq që përhapet për dikë i sjell nganjëherë shumë ngatërresa e pasoja të këqija. Syri i bardhë si një kokërr dardhë

- fj. u. thuhet kur dikush duket nga sytë se është njeri i butë e zemërmirë. Kur shtie drutë, hap sytë fj. u. shih te SHTIE. Fusha ka sy e mali (pylli, gardhi, muri) ka veshë fj. u. shih te FUSH/Ë,~A.
- SHAKULL** m. 2. Gjyryk. Luaj shakullin. Hekuri punon, shakulli gjëmon. fj. u.
- SHALAQE** f. shih KAPËRCYELL,~ELLI 1. Kapërcej shalagen. Shalaje më shalaje dilet në faqe. fj. u.
- SHALQI** m. bot. Nuk mbahen dy shalqinj (dy kunguj) nën një sqetull (në një dorë) fj. u. shih te KUNGULL,~I.
- SHARRË** f. Sharra që pret, shkëlqen edhe vetë fj. u. ai që mëson e ndihmon të tjerët, mëson e përfiton edhe vetë prej tyre.
- SHAT** m. S'bëhet vreshti me urata, po me shata e me lopata. fj. u. Shati tërheq nga vetja fj. u. keq. thuhet për një njeri që mendon më parë a më shumë për të mirën e vet, për nevojat e veta.
- SHEJTAN** m. Më mirë djepin thatë (bosh) se shejtanin brenda fj. u. shih te DJEP,~I.
- SHEMBEM** vetv. Shtëpia pa njeri brenda shembet. fj. u.
- SHES** kal. Shtëpinë shite, shokun mbaje! fj. u. për shokun e vërtetë mos kurse asgjë, miqësia e vërtetë s'ka të paguar. I zoti e shet, tellalli s'e jep fj. u. shih te ZOTI (i).
- SHËNDET** m. Puna është shëndet. fj. u.
- SHËNDOSHEM** vetv. S'shëndoshet (s'majmet) kau ditën që do të theret fj. u. shih te KA,~U.
- SHËRBIM** m. Kush nuk i bën shërbim kalit, bën udhën më këmbë. fj. u.
- SHI** m. Shiu i butë lag të marrë e të urtë. fj. u.
- SHIGJETULL** f. zool. Nuk hahen ato petulla që t'i jep (t'i sjell) shigjetulla fj. u. shih te PETULL,~A.
- SHIKOJ** kal. Mos shiko se ç'thotë, po shiko se ç'bën në botë! fj. u. Mos i shiko gunën, po shikoj punën! fj. u. Bëj atë që duhet, mos shiko se ç'thuhet! fj. u. Mos shiko (mos vështro) gjithnjë përpjetë, po shiko (vështro) dhe tatëpjetë! fj. u. shih tek TATËPJETË. Mos i shiko shkallët, por shikoj oborrin! (dikujt) fj. u. shih te SHKALL/Ë,~A. Mos i shiko shpatullat, por shikoj zemrën! fj. u. shih te SHPATULL,~A.
- SHINIK** m. Shiu në korrik, misri me shinik. fj. u.
- SHITEM** vetv. Kush shitet i madh, është i vogël. fj. u. Nuk shitet kali me një të penguar. fj. u.
- SHKALLË** f. Mos i shiko shkallët, por shikoj oborrin! (dikujt) fj. u. mos e vlerëso dikë nga ajo që ka trashëguar prej të tjerëve, por çmoje nga puna që bën ai vetë e nga aftësitë që ka. Burri në shkallë, po shkalla në mur fj. u. njeriu duhet të punojë e të luftojë me guxim, por me mend në kokë; të ecim përpara duke e menduar e peshuar mirë atë që bëjmë. Kur s'ke shkallën, merr litarin (është i mirë edhe litari) fj. u. për të kryer një punë, kur nuk i ke mjetet më të mira, mund të përdorësh edhe mjete të tjera jo aq të volitshme, mjafton që puna të bëhet; kur s'ke pulën, ha edhe sorrën. Në çati ngjiten me shkallë fj. u. çdo punë kërkon mjetet e nevojshme. Shkalla e lartë do (kërkon) këmbë të forta fj. u. duhet t'i matim mirë fuqitë e të përgatitemi me kujdes kur ia hyjmë një pune të rëndësishme.
- SHKARPË** I f. kryes. Nuk piqet buka me shkarpa fj. u. nuk mund të kryhet mirë një punë pa pasur mjetet e nevojshme.
- SHKELM** m. Më mirë shkelmi se helmi fj. u. më mirë të ta thonë a të ta bëjnë të keqen hapur, sesa të të godasin tinëz e me të pabesë.
- SHKËMB** m. Gjuha çan shkëmbin (gurin) fj. u. shih te GJUH/Ë, ~A I.

- SHKËNDIJË** f. Një shkëndijë ndez një mal. fj. u. Shkëndijat (shkëndijëzat) dalin në maj fj. u. çdo punë ka kohën e vet. S'ka ç'i bën shkëndija eshkës së njomë (së lagur) fj. u. për t'ia dalë në krye një pune nuk mjafton vetëm dëshira e mirë, por duhen plotësuar me kohë kushtet e nevojshme.
- SHKËNDIJËZ** f. Shkëndijëzat (shkëndijat) dalin në maj fj. u. shih te SHKËNDIJ/Ë,~A.
- SHKOJ** jokal. Më thua me kë shkon, të të them se kush je. fj. u. Për një gozhdë shkoi potkoi. fj. u. Për një pe, për një gjilpërë shkoi dëm një gunë e tërë. fj. u. Shkoi vapa me gushtin fj. u. shih te GUSHT, ~I. Gjej njëherë bari, pastaj shko e bli dhi fj. u. shih te BARI,~U. Kush shkon pas brumbullit, te plehu do ta shpjerë fj. u. shih te BRUMBULL,~I. Më mirë të shkojë kryet (koka) se fytyra fj. u. shih te KRYE,~T. Qentë le të lehin, karvani shkon përpara fj. u. shih te LEH. Shkoi shyta të kërkojë brirët, la edhe veshët fj. u. iron. shih te SHYT/Ë,~A. Tymi të shkojë drejt, pa le të jetë oxhaku i shtrembër! fj. u. shih tek TYM,~I.
- SHKOP** m. Kur s'ke shokun, pyet shkopin. fj. u. Kujto (zër në gojë) qenin, rrëmbe (bëj gati) shkopin fj. u. shih te QEN,~I. Shkopin, po e ndyve të tërë, s'ke ku e kap fj. u. shih te NDYJ.
- SHKREP** kal. Rrufeja nuk shkrep dy herë mbi një lis. fj. u. Ku shkrep kjo fjalë ku qëllon kjo fjalë?
- SHKUND** kal. Tjetër i shkund, tjetër i ha. fj. u.
- SHKURTËR** mb. I gjati është shërbëtori i të shkurtrit. fj. u. Gënjeshtër i ka këmbët të shkurtra fj. u. gënjeshtër zbulohet shpejt, del në shesh menjëherë.
- SHKURTOJ** kal. Shkurti shkurton urët fj. u. në shkurt bën ftohtë dhe harxhohen shumë dru për zjarr.
- SHOH** kal. Nuk sheh syri, po sheh mendja. fj. u. Kur të shoh me sy, më bie ndër-mend për ty. fj. u. Dielli shihet (duket) që në mëngjes (që kur lind) fj. u. shih te DIELL,~I. Mos mburr degët pa parë rrënjët fj. u. shih te RRËNJ/Ë,~A. Sheh rrushi rrushin (fiku fikun) e piqet fj. u. shih te RRUSH,~I. Kur t'i hipësh kalit, shihi potkonjtë fj. u. shih te POTK/UA,~OI.
- SHOK** m. Trimi i mirë me shokë shumë. fj. u. Atij që i thërret shok, i ke thirrur vëlla. fj. u. Thuamë ç'shokë ke, të të them cili je. fj. u. Në rrezik e në nevojë shoku-shokun të ndihmojë. fj. u. Shtëpinë shite, shokun mbaje! fj. u. për shokun e vërtetë mos kurse asgjë, miqësia e vërtetë s'ka të paguar. Kush i bën varrin shokut, bie vetë brenda fj. u. shih te VARR,~I.
- SHOSH** kal. Shosha shosh, sita sit fj. u. shih te SHOSH/Ë,~A.
- SHOSHAR** m. Shoshari shoshën e tij lëvdon. fj. u.
- SHOSHË** I f. Nuk trembet ariu (arusha) me shoshë. fj. u. Nuk mbulohet (nuk zihet, nuk fshihet) dielli me shoshë fj. u. shih te DIELL,~I. E vunë në sitë e në shoshë dikë shih te SIT/Ë,~A. Shosha shosh, sita sit fj. u. secili ka aftësitë e veta e bën punën që ka mundësi të bëjë.
- SHOSHIT** kal. Mos e fut në hambar pa e shoshitur fj. u. mos e bëj mik dikë pa e njohur mirë!
- SHPATULL** f. Shpatullat s'bëhen tri fj. u. edhe mundësia a aftësia për të përballuar punët e vështirësitë ka një kufi. Shpatullat duan këmbë fj. u. për t'u bërë ballë detyrave a vështirësive duhet të i mbështetesh fort diku; duhet t'i mbështetësh këmbët në tokë. Mos i shiko shpatullat, por shikoji zemrën! fj. u. nuk vlen ai që ka trup të madh, por ai që ka shpirt të madh, që është trim e zemërgjerë. Shpatullat me zemrën s'janë motra fj. u. mund të jetë dikush trup-madh, por frikacak, ndërsa dikush mund të jetë i imët nga trupi, por trim.

- SHPEJTOJ** kal. Kush shpejton, fiton. fj. u. Shpejtoni, se jemi vonë (s'kemi kohë).
- SHPËTUAR** mb. Njeriu i lajmëruar është gjysmë i shpëtuar. fj. u.
- SHPIE** kal. Shpjer gojën te buka e jo bukën te goja! fj. u. përpiqu, luaj këmbë e duar që të sigurosh atë që të duhet.
- SHPIKEM** vetv. 3. Pës. e SHPIK I 1. Lugë-lugë shpiket një kupë. fj. u. Nuk shpiket deti me lugë. fj. u.
- SHPIRT** m. Nga del fjala, del shpirti. fj. u. fjala e dhënë nuk kthehet.
- SHPOJ** kal. Shpoj një vrimë. Uji shpon gurin. fj. u. Po të shposh, do të dëgjosh. fj. u. Pika (cirka) shpon gurin fj. u. shih te PIK/Ë,~A.
- SHPORTË** f. Vezët në shportë e shportën në dorë! fj. u. çdo gjë që ka rrezik të dëmtohet, duhet mbrojtur e siguruar në mënyrë të plotë, masat që merren për diçka, nuk duhet të jenë gjysmake. Kur dëgjon se ka shumë pemë, merr shportën e vogël fj. u. shih te PEM/Ë,~A.
- SHPRUSH** kal. Shprushe zjarrin, prit shkëndijat. fj. u.
- SHPUZË** f. Nuk futet shpuza në gji. fj. u.
- SHQEME** f. bot. Ç'i bën dhia shqemes, shqemja ia bën lëkurës fj. u. kush bën keq, gjen keq; ç'të bësh, atë do të të bëjnë.
- SHQIPONJË** f. Më mirë shqiponjë një ditë, se sorrë një vit. fj. u. Shqiponja nuk ha miza fj. u. njerëzit e shquar nuk merren me çikërrima e me gjëra të ulëta.
- SHQYEJ** kal. Të shqeva dysh! Luga e madhe të shqyen gojën. fj. u.
- SHTAMBË** f. Shumë herë vete shtamba për ujë e një herë thyhet. fj. u.
- SHTATË** num. them. Mat shtatë (tri, dhjetë) herë e pre një herë! fj. u. shih te MAT.
- SHTEG** m. Kush ka shteg, s'ka mot të lig. fj. u. kush ka rrugë për të bërë, nuk pyet për mot të keq; ai që synon të arrijë pa tjetër një qëllim, nuk do t'ia dijë për vështirësitë.
- SHTER** jokal. Nuk shteret deti me lugë. fj. u.
- SHTËPI** f. Shtëpinë shite, shokun mbaje! fj. u. Nuk mbahet shtëpia me miell hua fj. u. Hesapi i shtëpisë nuk del në pazar fj. u. shih te HESAP,~I. I zoti e din ku i pikon shtëpia (çatia) fj. u. shih te ZOTI (i). Në shtëpinë e të varurit nuk e zënë në gojë litarin fj. u. shih te VARUR (i,e).
- SHTIE** kal. Kush ka nge, shtie rruaza në pe. fj. u. Kur i shtie drutë, hap sytë! fj. u. kur fillon një punë të rëndësishme, duhet të përgatitesh mirë e të kesh shumë kujdes. Mos shtjer kripë në gjellën e botës! fj. u. thuhet kur e këshillojnë dikë që të mos merret me punë që nuk i përkasin, të mos futë hundët në punët e të tjerëve. Po shtive, mizën (milingonën), të iku hambari fj. u. një armik i brendshëm, sado i vogël qoftë, mund të të sjellë një dëm shumë të madh.
- SHTOJ** kal. Kali i mirë e shton (vetë) tagjinë fj. u. shih tek TAGJI,~A.
- SHTRAT** m. Shtriji (zgjati) këmbët sa ke shtratin (jorganin, plafin) fj. u. shih te JORGAN,~I.
- SHTREMBËR** f. E drejta fiton mbi të shtrembrën. fj. u. E shtrembra dhe gënjeshtra nuk fshihen. fj. u. E shtrembra i ka këmbët të shkurtra. fj. u.
- SHTREMBËR** mb. Një dru e shtrembër rrëzon (prish) gjithë stavën fj. u. shih te STAV/Ë,~A. Tymi të shkojë drejt, pa le të jetë oxhaku i shtrembër fj. u. shih tek TYM,~I.
- SHTREMBËR** ndajf. Të rrimë shtrembër e të flasim drejt! fj. u. sido që të jetë, duhet të themi të vërtetën, të themi atë që është, edhe pse s'na pëlqen.
- SHTREMBËT** ndajf. Rri shtrembët e fol drejt. fj. u.

- SHTRENTJË** mb. Gjëja e shtrenjtë zë më lirë. fj. u.
- SHTRENTJË** ndajf. Gjëja e lirë zë shtrenjtë. fj. u.
- SHTRIJ** kal. Shtriji (zgjati) këmbët sa ke jorganin (plafin, shtratin) fj. u. shih te JORGAN,~I.
- SHTROJ** kal. Demin e shtron zgjedha fj. u. shih te ZGJEDH/Ë,~A. Si të shtrosh, ashtu të mbulojnë fj. u. si të sillësh me të tjerët, ashtu do të sillen edhe të tjerët me ty. Sofrën shtroje edhe me bukë e kripë (e qepë) fj. u. shih te SOF/ËR,~RA.
- SHTRUAR** ndajf. Guri që punon shtruar, bën miell të butë fj. u. njeriu këmbëngulës dhe fjalëpakë bën punë të mirë.
- SHTYLLË** f. Nuk mbahet shtëpia me një shtyllë. fj. u.
- SHTYP** kal. Zure gjarprin, shtypi kokën! fj. u. Gjarprit shtypi kokën! fj. u. shih te GJARP/ËR,~RI.
- SHUAR** mb. 9. euf. I vdekur. Më mirë i shuar se i turpëruar. fj. u. Më mirë i shuar se gjallë e i harruar. fj. u.
- SHUHEM** vetv. b) vdektë! Nuk u shua (nuk humbi) pazari për gjilpëra fj. u. shih te HUMB.
- SHULËT** mb. 1. I pjerrët, i shtrembër, që vjen shul. Parmenda e shulët e bën kaun të mpitë. fj. u.
- SHUMË** mb. I shumtë. Janë të shumë. Nga të mirat e shuma. Nga të qarët e shumë. I shumti si lumi, i pakë si gjaku. fj. u.
- SHUMË** I pakuf. Trimi i mirë me shokë shumë. fj. u. Më mirë pak e saktë, se shumë e për lumë. fj. u.
- SHUMTË** mb. Fjalët e shumta janë fukarallëk. fj. u.
- SHURDHËR** mb. Rri si i shurdhri në kuvend. fj. u. nuk kupton e nuk merr vesh asgjë nga ato që thuhet. Atë që ka shumë fjalë, një i shurdhër e mund. fj. u.
- SHYT** mb. Shkoi shyta të kërkujë brirët, la edhe veshët fj. u. iron. shkoi për të fituar diçka, po humbi edhe atë që kishte pasur; vajti për t'i kërkuar llogari dikujt, po i kërkuan llogari atij vetë dhe e vunë përpara.
- TABIAT** m. bised. vjet. Fshat e zanat, derë e tabiat. fj. u. njerëz të vendeve a të familjeve të ndryshme kanë zakone të ndryshme.
- TAGJI** f. Kali i mirë e shton (vetë) tagjinë fj. u. kush di të punojë e të sillet si duhet, i sjell vetes të mira. Kali ha tagjinë, gomari mbart bucelat fj. u. thuhet kur dikush rri rehat e bën qejf, ndërsa dikush tjetër copëtohet në punë.
- TAKOHEM** vetv. Mali me mal s'takohet, njeriu me njeriun takohet. fj. u.
- TALENT** m. Një herë talent e dhjetë herë punë. fj. u.
- TAMAH** m. bised. Nga tamahu heq stomaku. fj. u.
- TATAREQ** m. bot. Baba, atë. Vajza e tatës. Djali i tatës. Bëmë, o tatë, të të ngjaj. fj. u.
- TATËPJETË** f. Tatëpjeta për pleq, përpjeta për djem. fj. u.
- TATËPJETË** Mos shko (mos vështro) gjithnjë përpjetë, po shko (vështro) edhe tatëpjete fj. u. kush çan përpara, duhet të shohë dhe rrugën që ka bërë, duhen nxjerrë gjithnjë mësim nga e kaluara, s'duhet harruar e kaluara.
- TELLALL** m. I zoti e shet, tellalli s'e jep fj. u. shih te ZOTI (i).
- TEPROJ** kal. Çfarë të bësh ta bëjnë dhe ta teprojnë. fj. u. atë që ua bën të tjerëve, ata ta bëjnë ty madje në një masë më të madhe; ç'të bësh do ta bëjnë edhe më keq.
- TERJAK** ndajf. bised. Ashtu si duhet, saktë. Fol pak e terjak dhe jo shumë e për lumë. fj. u.
- TËRMALE** f. E përpjetë. Ngjiti tërmalen. Tërmales ka teposhtën. fj. u.

- TIGAN** m. Urtë e butë e plot tigani fj. u. iron. shih tek URTË.
- TINËZ** ndajf. Kush flet tinëz, i bie shpinës. fj. u.
- TOP** m. S'të lënë topat të dëgjosh dyfekët fj. u. kur të zë një e keqe e madhe, i harron hallet e tjera më të vogla.
- TOPANXHË** f. vjet. S'bëhet dora topanxhë fj. u.
- TRADHTUAR** mb. 2. përd. em. sipas kuptimit të mbiemrit. I tradhtuari, i përvëluari. fj. u.
- TRAP** I m. Mos ec me vrap, se bie në trap. fj. u. Pa hedhur trapin, mos thuaj «hop». fj. u.
- TRAPIT** I jokal. Kush trapit shumë, mbetet pa punë. fj. u.
- TRASTË** f. E di Gjoni çfarë ka në trastë (në thes) fj. u. i di secili hallet e veta, e di i zoti ku i pikon çatia. Fjalë të mira e gurë në trastë (në torbë, në thes) shih te GUR,~I. Ruan me trastë e prish me thasë fj. u. kursen aty ku nuk duhet, nuk di ku të kursejë, është i shtrenjtë në krunde e i lirë në miell; harxhon më shumë se sa kursen.
- TRE** m. num. them. Shpatullat s'bëhen tri fj. u. shih te SHPATULL,~A.
- TREGOJ** kal. Ç'ka zemra e tregon fytyra. fj. u.
- TREMBEM** vetv. Nuk trembet ariu (arusha) me shoshë fj. u. shih te SHOSH/Ë,~A. S'trembet ujku nga mushkonjat fj. u. shih tek UJK,~U I.
- TRET** kal. Goja tret edhe malet fj. u. shih te MAL, ~I.
- TRI** f. num. them. Shpatullat s'bëhen tri fj. u. shih te SHPATULL,~A.
- TRIM** m. Trimi i mirë me shokë shumë. fj. u. Trimi i mirë në luftë njihet. fj. u.
- TRU** m. anat. Lima e butë të ha trutë fj. u. shih te LIM/Ë, ~A.
- TRUNG** m. Ndezja e zjarrit nuk fillon nga trungu fj. u. punët duhen nisur nga koka e jo nga bishti, puna kryhet mirë kur nis mbarë.
- TRUP** m. Mendja e shëndoshë në trup të shëndoshë. fj. u. libr. Trupi shëndoshet me të punuar, mendja ndriçohet me të mësuar. fj. u.
- TUL** m. Gjuha është prej tuli fj. u. shih te GJUH/Ë, ~A I. I futi (i shtiu) veshët në tul bëri sikur nuk e dëgjoji dikë; e bëri veshin të shurdhër.
- TUNDEM** vetv. Muri tundet, burri s'tundet. fj. u.
- TUNDOJ** kal. I miri të ndihmon, i ligu (i keqi) të tundon. fj. u.
- TURI** m. Të gjithë derrat një turi kanë. fj. u. të gjithë të këqijtë njësoj janë.
- TURP** m. Turpi të lë pa bukë. fj. u. Puna s'ka turp. fj. u. nuk është turp të punosh, puna është nder.
- TYM** m. U qorroi tymi sytë. Nuk ka tym pa zjarr. fj. u. Iku nga tymi e ra në zjarr fj. u. shpëtoi nga një e keqe e vogël e ra në një të keqe më të madhe, iku nga shiu e ra në breshër. Tym i të shkojë drejt, pa le të jetë oxhaku i shtrembër! fj. u. punët të shkojnë mirë pa le të thotë ç'të dojë bota; nuk çan kokën s'e ç'thotë bota, kur i ka punët mirë.
- THAHEM** vetv. Nuk thahet, (nuk soset) deti me lugë fj. u. shih te DET~I.
- THAJ** kal. Luga mbush barkun, piruni than gurmazin fj. u. shih te LUG/Ë,~A.
- THANË** f. Thanat nuk numërohen fj. u. gjërat pa vlerë nuk numërohen; gjërat e vogla e pa rëndësi nuk duhen vënë re megjithëse mund të mos na pëlqejnë. Ka ngrënë lule thane. Sa thana janë, kokrra s'bëjnë fj. u. sa fjalë fliten, nuk duhen besuar.
- THATË** mb. Kroi (pusi) i mirë njihet në kohë të thatë fj. u. shih te KRUA, KROI.
- THATË** ndajf. Më mirë djepin thatë (bosh) se shejtanin brenda fj. u. shih te DJEP,~I.

- THATË** as. S'këndon zhaba në të thatë fj. u. shih te ZHAB/Ë,~A.
- THEKËR** f. bot. Kur s'ke grurë, e mirë është edhe thekra fj. u. njeriu bën si të ketë, kënaqet me atë që ka; kur s'ke pulën, ha edhe sorrën. Thekra është e gjatë, po gruri hahet fj. u. vlen puna, jo pamja, mos i shih gunën, po punën.
- THELB** m. Ka thelb buka fj. u. buka që të japin vlen shumë, nuk bën të hash bukën e të përmbysësh kupë.
- THELË** f. Thela e madhe të ngec në fyt. fj. u. kush lakmon shumë, e pëson.
- THEM** kal. Bluaje, pa thuaje! fj. u. Unë them «ja ujk!» ti kërkon gjurmët (kur ke ujkun, mos i kërko gjurmët!) fj. u. shih tek UJK,~U I.
- THER** kal. S'shëndoshet ('majmet) kau ditën që do të theret fj. u. shih te KA,~U.
- THES** m. Nuk fshihet derri në thes fj. u. shih te DERR,~I. Nuk futet (nuk hyn, nuk fshihet) minarja (hosteni) në thes fj. u. shih te MINAR/E,~JA. S'futen pleshtat në thes ('mbliidhen pleshtat në grusht) shih te PLESHT,~I. Gjetei hajduti thesin (u poq hajduti me thesin) fj. u. keq. gjetei tenxherja kapakun, gjetei rrasa vegshin. Shiko drithin e jo thesin! fj. u. shih DRITH,~I. E di mesi se ç'ka thesi fj. u. shih te MES,~I. Ruan me trastë e prish me thasë fj. u. shih tek TRAST/Ë,~A. Thesi bosh (i zbrazur, pa gjë) s'qëndron ('rri) më këmbë fj. u. njeriu nuk jeton e nuk punon dot pa ngrënë.
- THËLLËZË** f. zool. Kusia mbi prush, thëllëza fushë fj. u. shih te KUSI, ~A.
- THËNË** f. Më mirë puna se e thëna. fj. u. Nga e thëna në të bërë është në mes një det i tërë. fj. u.
- THËRRIME** f. Kush ha bukë, bën edhe thërrime fj. u. shih te BUK/Ë,~A.
- THIKË** m. Dhurata e armikut o helm o thikë fj. u. shih te HELM,~I I.
- THOI** m. S'ndahet mishi prej thoit fj. u. shih te MISH,~I. Leshtë e ujkut, thonjtë e bufit fj. u. shih tek UJK,~U I.
- THUMB** m. Për një thumb (gozhdë) shkoi (humbi) potkoi fj. u. shih te GOZHD/Ë,~A. Njëri (i bie) thumbit (gozhdës), tjetri potkoi shih te GOZHD/Ë,~A. Një thumb, njëqind herë ta rrahësh një majë nxjerr fj. u. mospërf. thuhet kur kemi të bëjmë me një njeri shumë kokëfortë, që nuk pranon vërejtjet dhe këshillat e dobishme të të tjerëve (në kuptimin «sa do të mundo-hesh, nuk nxjerr dot gjë nga një njeri që nuk ndryshon»).
- THUPËR** f. Ose hu ose thupër fj. u. shih te HU,~RI.
- THYEJ** kal. Mendja e madhe të thyen qafën (zverkun) fj. u. shih te MENDJ/E,~A. Gjuha kocka s'ka e kocka thyen fj. u. shih te GJUH/Ë,~A I.
- THYHEM** vetv. Buka që thyhet, s'ngjitet më fj. u. shih te BUK/Ë,~A. Po u thye kulaçi, s'ngjitet më fj. u. shih te KULAÇ,~I. Më mirë të pritët koka (kryet), se të thyhen gjunjët fj. u. shih te GJU,~RI.
- UDHË** f. Kali botës të lë në udhë fj. u. shih te BOT/Ë,~A I.
- UGAR** m. Si më ha barin, më puno ugarin. fj. u. thuhet kur këshillohet dikush që t'i përgjigjet plotësisht me punë pagës që i jepet.
2. Punimi i parë i tokës. Ugari i janarit, vllaga e beharit (misri i hambarit). fj. u.
- UJË** m. 'bëhet gjaku ujë fj. u. nuk mund të mohohen lidhjet e afërta farefisnore.
Mulliri bluan me aq ujë sa ka fj. u. shih te MULLI,~RI. Nuk shkon gjithmonë kungulli mbi ujë fj. u. shih te KUNGULL,~I. Shto ujë e shto miell mospërf. shih te SHTOJ. E bëri dy ujë e një oriz e prishi diçka, e bëri të cilësisë së dobët. Kush ha djathë nga të hoxhës, pëlçet për ujë fj. u. shih te HOXH/Ë,~A.

- UJË** as. 1. shih UJ/Ë,~I. Ujë të fle, hasmi s'fle. fj. u.
- UJK** I m. Delen (dhinë) që ndahet nga tufa, e ha ujku. fj. u. Ujku mjegull do. fj. u. Kur thonë «ngordhi ujku», atëherë ruaje gomarin. fj. u. Qeni i keq e sjell ujkun në vathë. fj. u. Nuk fle (nuk kulot) delja me ujkun bashkë. fj. u. Ujku bari s'bëhet. fj. u. I tregon lëkurën e ujkut dikujt e frikëson, e tremb dikë duke iu kanosur me diçka. S'trembet ujku nga mushkonjat fj. u. thuhet për dikë që nuk do t'ia dijë fare kur e kërcënon një kundërshtar i pafuqishëm. Leshtë e ujkut, thonjtë e bufit fj. u. kundër të keqit e të egrit duhet përdorur forca. Unë them «ja ujku!», ti kërkon gjurmët (kur ke ujkun, mos i kërko gjurmët!) fj. u. thuhet për dikë që kërkon të fshehtë diçka që duket fare qartë ose që e kërkon të vërtetën jo aty ku ajo duket qartë, por aty ku ajo mbulohet e errësohet. Çakalli bëri kërkinë, ujkut i doli nami fj. u. thuhet për dikë që ka bërë shumë të këqija, por është fshehur pas dikujt tjetër që njihej nga të gjithë si keqbërës. Dhentë pa bari i ha ujku një nga një fj. u. shih te BARI,~U I.
- ULËRIMË** f. Kush bëhet me ujqër, do nxerë ulërimën. fj. u.
- URATË** f. S'bëhet vreshti me urata, po me shata e me lopata. fj. u.
Hardhia e bën rrushin, ferra merr uratën fj. u. shih te HARDHI,~A.
- URË** I f. sh Kur s'ka urë, edhe vau është i mirë fj. u.
S'bëhet urë me gëzhdalla fj. u. çdo gjë ka nevojë për mjetin ose për mënyrën e vet që të bëhet.
- URË** II f. Shkurti shkurton urët fj. u. shih te SHKURTOJ.
- URITUR** mb. I ngopuri s'e kujton të uriturin. fj. u.
- URTË** ndajf. Urtë e butë e plot tigani fj. u. iron. thuhet për dikë që përpiqet ta ketë mirë me të gjithë, të mos i prishë marrëdhëniet me asnjëri, që t'i shkojnë mbar punët e veta.
- USHE** f. shih USHEZ/Ë,~A 1, 2. Ruaj ushenë të të vijë gjahu! fj. u.
- UTHULL** f. Uthulla e fortë prish enën e vet fj. u. thuhet për dikë që nxehet shpesh, pa shkak dhe që kështu dëmton veten. Vaj e verë e uthull bised. ylberi.
- VA** m. sh Doli në va. Kur s'ka urë, edhe vau është i mirë. fj. u. Edhe vau të mbyty fj. u. edhe rreziqet a të këqijat që duken të vogla mund të të sjellin një dëm të madh, prandaj nuk duhen nënvlerësuar.
- VADE** f. vjet. Afat; kohë. I ka shkuar vadja. Rruga vade s'ka. fj. u.
- VAJ** I m. S'del vaj nga guri fj. u. thuhet kur është e pamundur të bëhet diçka. U derdh vaji, s'mblidhet më fj. u. thuhet për një punë a për një veprim të gabuar që bëhet dhe nuk mund të ndreqet më.
Vaji në lakra bie fj. u. shih te BIE I. E drejta rri si vaji mbi ujë fj. u. shih te DREJT/Ë,~A (e). Humbi në vaj e fitoi në presh fj. u. më shumë humbi se fitoi, s'fitoi gjë. I rri punës përsipër si vaji mbi uthull shih tek UTHULL,~A. Vaj e verë e uthull bised. ylberi.
- VALË** f. Lepuri në mal e vala në zjarr. fj. u. iron.
- VALLE** f. Disa jashtë valles dinë shumë këngë fj. u. kur nuk punon vetë e s'ke ndonjë barrë a përgjegjësi mbi supe, është lehtë t'u japësh mend të tjerëve.
- VAMPIR** m. Vampiri e njeh luginin fj. u. njeriu i keq e njeh shokun e tij, i ligu shkon me të ligun.
- VAPË** f. Shkoi vapa me gushtin fj. u.
- VAR** kal. Kur ta varësh zilen, duhet t'i biesh fj. u. kur ta marrësh përsipër një punë a detyrë, duhet ta kryesh mirë.
- VAREM** vetv. pës. Çdo mish (berr) varet nga këmbët e veta (në çengelën e vet) fj. u. shih te MISH,~I.

- VARUR** mb. Në shtëpinë e të varurit nuk e zënë në gojë litarin fj. u. thuhet për të paralajmëruar që të mos flitet për një çështje, nga e cila mund të lëshohet shumë dikush që është i pranishëm (ngaqë ai ka një gjymti a të metë të tillë, ka vuajtur shumë a e ka pësuar nga diçka, ka kryer një faj të tillë etj.).
- VARR** m. Kush i bën varrin tjetrit, bie vetë brenda. fj. u.
Varret nuk flasin fj. u. i vdekuri i merr të fshehtat në varr. I vuri gurin e varrit diçkaje e mbylli një çështje që të mos e marrin vesh të tjerët.
- VARRICË** f. krahin. Druri i shtrembër prish tërë varricën. fj. u.
- VATËR** f. Lopa në mal, përsheshi në vatër (në xham) fj. u. shih te LOP/Ë,~A. Vatër kulture institucion që merret me organizimin e drejtimin e veprimtarisë kulturore e artistike në një fshat të vogël.
- VDEKJE** f. E pret vdekja. Gjumi është vëllai i vdekjes. fj. u.
- VDEKUR** m. I vdekuri me të vdekurit, i gjalli me të gjallët. fj. u. Nuk ngjallet i vdekuri.
- VDES** jokal. Më mirë të vdesësh më këmbë, sesa të rrosh i gjunjzuar. fj. u.
- VEÇUAR** mb. I veçuari, i munduari fj. u. kush ndahet nga shokët, është i pa-fuqishëm e vuan.
- VEGSH** m. E di luga se s'ka vegshi (vorba, poçja) fj. u. shih te LUG/Ë,~A. Gënjeshtra e bën vegshin, por nuk ia vë kapakun fj. u. puna e keqe a veprimi i keq merret vesh, gënjeshtra nuk fshihet dot.
- VEND** m. Sipas vendit bëhet kuvendi. fj. u.
Guri është i rëndë në vend të vet fj. u. shih te GUR,~I.
- VES** m. Përtacia është nëna e veseve. fj. u.
- VESH** m. S'çalon gomari nga veshët fj. u. shih. te ÇALLOJ. Daullja bie për ata që kanë veshë fj. u. shih te DAULL/E,~JA. I hyn në një vesh e i del nga tjetri (nga një vesh i hyn e nga tjetri i del) mospërf. shih te HYJ. Fusha ka sy e mali (pylli, gardhi, muri) ka veshë fj. u. shih te FUSH/Ë,~A. Një sy verboje, një vesh shurdhoje! shih te SY,~RI. Shkoi shyta të kërkojë brirët, la edhe veshët fj. u. iron. shih te SHYT,~Ë.
- VET** pron. vetv. Guri është i rëndë në vend të vet. fj. u. Shprehu mendimin e vet. Për këtë flet në veprën e vet.
- VETE** përem. vetv. Shati tërheq nga vetja fj. u. keq. shih te SHAT,~I.
- VETE** jokal. Kush vete në mulli, doemos do të përmiellet. fj. u.
Më thuaj me kë vete të të them se kush je! fj. u.
- VETËM** mb. Delen e vetme e ha ujku. fj. u.
- VETËTIN** jokal. Po s'vetëtin, nuk gjëmon. fj. u.
- VEZË** f. Vezët në shportë e shportën në dorël! fj. u. shih te SHPORT/Ë,~A. Ka ngordhur ajo pulë që bënte ato vezë shih te PUL/Ë,~A. Më mirë një vezë sot, se një pulë mot fj. u. më mirë diçka më të vogël në çastin e duhur, sesa një gjë më të madhe më vonë.
- VËLLA** m. Vëllai për vëllanë fj. u. vëllezërit duhet ta ndihmojnë kurdoherë njërit-tjetrit.
Gjumi është vëllai i vdekjes. fj. u. shih te GJUM/Ë,~I.
- VËNG** m. Çdo berr varet në vëng të vet. fj. u.
- VËRTETË** f. Më mirë një e vërtetë e hidhur se një gënjeshtrë e ëmbël. fj. u.
Shkoftë kohë e shkoftë mot, e vërteta del më not. fj. u. e vërteta del kurdoherë në shesh.
- VËRRI** f. Dhia në malësi, delja në vërri fj. u. shih te DHI,~A.
- VËSHTRONJ** kal. Mos vështro (mos shiko) gjithnjë përpjetë, por vështro (shiko) dhe tatëpjetë fj. u. shih tek TATËPJETË.
- VIHEM** vetv. S'vihen dy gilpëra majë më majë fj. u. shih te GJILPËR/Ë,~A.

- VIJË** f. Një vijë nuk e kthen lumin prapa fj. u. shih te LUM/Ë,~I.
- VLAGË** f. Ugari i janarit është vlagë e beharit. fj. u.
- VOGËL** mb. I vogël për prehër, i madh për zemër fj. u. shih te PREH/ËR,~RI. Atje ku bëhet dasmë e madhe, merr lugë të vogël! fj. u. shih te LUG/Ë,~A. Ku të tregojnë copën e madhe, merr lugën e vogël! fj. u. shih te LUG/Ë,~A.
- VONË** ndajf. Më mirë vonë se kurrë. fj. u.
- VORBË** f. E di luga se ç'ka vorba (vegshi, poçja) fj. u. shih te LUG/Ë,~A.
- VOZË** f. Gjëmon voza që s'ka verë (që është bosh). fj. u.
- VRAP** m. Bëje (mate, lëshoje) vrapin sa ke hapin! fj. u. vepro sipas mundësisë që ke.
- VRAPOJ** jokal. Kush vrapoi, bloi. fj. u.
- VRAS** kal. E di gomari ku e vret samari fj. u. shih te GOMAR,~I.
- VRESHT** m. S'bëhet vreshti me urata, po me shata e lopata. fj. u.
- XHADE** f. Jeta nuk është xhade. fj. u.
- XHAMI** f. Kur s'ke bukë në shtëpi, pse çon vaj në xhami? fj. u.
- ZANAT** m. Është i zanatit është mjeshtër i mirë. Dy tre-katër zanate. Ka njëzet vjet në zanat. Zanati nuk vdes. Mos mëso mjeshterin, po merri zanatin. fj. u. Me ç'mjeshtër do të bjerë, atë zanat do të nxjerrë. fj. u.
- ZARAR** m. bised. Ik o qar, se kam zarar. fj. u. përdoret kur diçka duket sikur sjell përfitim, por në të vërtetë ka pasoja të këqija.
- ZBRAZEM** vetv. Arka u zbraz. Kazani i shpuar zbrazet vetë. fj. u.
- ZEMËR** f. Burri matet me zemër. fj. u. Zemra ndien zemrën. fj. u. Do të mbetet në zemrat tona. Atje ku jep fjalën vër zemrën. fj. u. E thotë goja po s'e thotë zemra. fj. u. Ç'ka zemra, e tregon fytyra. fj. u. Larg sysh, larg zemrës. fj. u. Bukë e krip e zemër. fj. u. Gjuha e ka rrënjën në zemër fj. u. shih te GJUH/Ë,~A. I. Mos i shiko shpatullat, po shikoj zemrën fj. u. shih te SHPATULL,~A. Shpatullat me zemrën s'janë motra fj. u. shih te SHPATULL,~A. I vogël për prehër, i madh për zemër fj. u. shih te PREH/ËR,~RI.
- ZEMËRIM** m. Zemërimi të verbon. fj. u. Zemërimi e plak njeriun. fj. u.
- ZEMËRMADHËSI** f. Zemërmadhësia dhe trimëria janë motra. fj. u.
- ZEZË** f. E zeza ndjell të zezën. fj. u. Mendja e madhe, e zeza e të zotit. fj. u.
- ZË** m. Ku ka zë, s'është pa gjë fj. u. mund të ketë diçka të vërtetë në fjalët që fliten rreth dikuajt a rreth diçkaje.
- ZË** kal. Kë zë dielli pa larë, s'i vete puna mbarë. fj. u. Kali e di vetë se ku e zë samari. fj. u.
- ZGJAT** kal. Zgjati (shtriji) këmbët sa ke jorganin (plafin, shtratin) fj. u. shih te JORGAN, ~I.
- ZGJEDHË** f. Demin e shtron zgjedha fj. u. njeriun e sertë e shtron puna.
- ZI** mb. Delja e zezë s'bëhet kurrë e bardhë fj. u. shih te DEL/E,~JA. E premtja e zezë (e madhe) fet. shih te PREMT/E,~JA (e).
- ZIHEM** vetv. Nuk zihet (nuk mbulohet) dielli me plisa fj. u. shih te DIELL,~I. Nuk zihet (nuk mbulohet, nuk fshihet) dielli me shoshë fj. u. shih te DIELL,~I.
- ZILE** f. Kur ta varësh zilen, duhet t'i biesh fj. u. shih te VAR.
- ZJARR** m. Iku nga tymi e ra në zjarr fj. u. shih tek TYM,~I. Lepuri në mal e vala (kusia) në zjarr fj. u. iron. shih te LEPUR, ~I. Ndezja e zjarrit nuk fillon aga trangu fj. u. shih tek TRUNG,~U. Peshku në det, tigani në zjarr fj. u. iron. shih te PESHK,~U.

- ZOG** m. Mbaje (ruaje) zogun sa e ke në dorë! fj. u. shfrytëzoji të gjitha mundësitë që të jepen për të arritur diçka, mos e humb rastin kur të vjen.
- ZOT** II m. Ti zot, unë zot, gomarin kush e kullot? fj. u.
Fushën pa zot, gjithkush e kullot. fj. u.
- ZOTI** m. vet. tr. e shquar. Puna do të zotin. fj. u.
I zoti e di ku i pikon çatia (shtëpia) fj. u. secili i di vetë hallet e tij; ai që merret me një punë i di më mirë të metat dhe vështirësitë e saj. I zoti e nxjerr (e qit) gomarin nga balta fj. u. shih te **BALT/Ë,~A**. I zoti e shet, tellalli s'e jep fj. u. thuhet kur për një punë bëhet pengesë jo ai, nga i cili varet zgjidhja e saj, por një njeri tjetër që s'i takon a që s'ka të bëjë fare ose ka të bëjë fare pak me të.
- ZOTI** mb. Kush është i zoti, s'i shkon zi moti. fj. u.
- ZULLUM** m. bised. Zullumi ka taksiratin afër. fj. u.
- ZVARRANIK** m. Më mirë asnjë mik, se të kesh mik një zvarranik. fj. u.
- ZVERK** m. Mendja e madhe ta thyen zverkun (qafën) fj. u. shih te **MENDJ/E,~A**.
- ZHABË** f. zool. S'këndon zhaba në të thatë fj. u.
- ZHBURRNIM** m. S'e duroi zhburrnimin. Më mirë vdekja, se zhburrnimi. fj. u.
- ZHBURRNOHEM** vetv. Burri nuk zhburrhohet. fj. u.
- ZHBURRNOJ** kal. Burrin më mirë vraje, po mos e zhburrho! fj. u.
- ZHDREDHUR** mb. Gjalmi i zhbredhur këputet shpejt. fj. u.
- ZHUZHULL** m. zool. Po t'i biesh pas zhuzhullit, do të shkosh në pleh. fj. u.
- ZHVESHUR** mb. 8. Përd. em. sipas kuptimit 1 të mbiemrit. I zhveshuri, i përqeshuri. fj. u.